



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS TIK NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Koordinoi hartimin e udhëzuesit

Eriksen Mersinllari, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Miranda Kurti

Koordinoi faqosjen

Eriksen Mersinllari

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

TABELA E PËRMBATJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS SË TIK-ut	5
1.1 Qëllimi i udhëzuesit	5
1.2 Përdoruesit e udhëzuesit.....	5
1.3 Struktura e udhëzuesit	6
II. RËNDËSIA LËNDËS SË TIK-ut.....	6
2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e TIK-ut.....	7
2.2 Risitë e lëndës së TIK-ut	8
2.3 Shtrirja e lëndës së TIK-ut	8
III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE LËNDORE.....	10
IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR	15
V. TEMAT NDËRKURRIKULARE	17
VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIE – NXËNIES NË TIK.....	19
VII.PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR	37
7.1 Llojet e planifikimeve	37
7.2 Planifikimi vjetor i lëndës	37
7.3 Planifikimi sipas periudhave	42
7.1 Planifikimi ditor	49
VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E TIK-UT	55
8.1 Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)	55
8.2 Vlerësimi i të nxënit (detyrë përmbledhëse)	56
8.3 Projekti kurrikular	59
8.4 Vlerësimi i të nxënit të nxënësit realizohet nëpërmjet:	68
8.4.1 Vlerësimi periodik.....	69
8.4.2 Vlerësimi përfundimtar	69

IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRA TË NDRYSHME NË LËNDËN E TIK-UT.....	71
9.1 Kriteret për kryerjen e detyrave	71
9.2. Reflektimi i mësuesit.....	71
9.3 Kriteret e vlerësimit të detyrave	72
X. BIBLIOGRAFIA:	74

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS SË TIK-ut

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi lëndor i lëndës së TIK-ut për arsimin e mesëm të lartë, trajton në mënyrë të detajuar aspektet kryesore të kurrikulës duke filluar që nga planifikimi i saj, deri te metodat e vlerësimit të të nxënit në kontekstin e zhvillimit të kompetencave gjatë zbatimit të programeve të TIK-ut për klasat 10-12. Në këtë udhëzues janë kombinuar të gjitha materialet në zbatim të kurrikulës me kompetenca, me eksperiencën dhe praktikat më të mira të mësuesve në shkollë. Udhëzuesi është hartuar për të mbështetur mësuesit e TIK-ut të planifikojnë një proces mësimdhënieje efektive duke përzgjedhur veprimtari dhe strategji të përshtatshme, të cilat do të ndihmojnë nxënësin në procesin e marrjes dhe përvetësimit të njohurive.

Udhëzuesi lëndor është një material ndihmës për mësuesit e lëndës së TIK-ut të klasave 10-12, i cili ka si qëllim:

- të zbërthejë dhe të sqarojë kërkesat e programit lëndor;
- të orientojë mësuesit në procesin e planifikimit (planit vjetor lëndor, planit të periudhës dhe planit ditor);
- të udhëzojë mësuesit në procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore, si dhe në nivelet e arritjeve;
- të ndihmojë mësuesit në përzgjedhjen e teknikave, strategjive dhe metodave mësimore që synojnë të zhvillojnë kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyç;
- të udhëzojë mësuesit që të përzgjedhin burime të ndryshme të nxëni për të përmbushur kërkesat e programit lëndor.
- të ofrojë sugjerime mbi strategjitë dhe metodat ndërvepruese të mësimdhënies/nxënies që mbështesin dhe zhvillojnë të nxënit aktiv, duke i lënë vend lirisë akademike të mësuesve dhe krijimtarisë së tyre;

1.2 Përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u vjen në ndihmë punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe si i tillë përdoret nga:

- mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit të cilët punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve dhe rezultateve të nxënësve në lëndën TIK-ut;
- të gjitha institucionet arsimore në varësi të MAS, njësitë arsimore vendore për zhvillimin profesional, këshillimin, vëzhgimin, monitorimin, kualifikimin e punonjësve arsimorë;
- institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e TIK-ut, të cilët mund t'i referohen për formimin fillestar të mësuesve të rinj.

1.3 Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi mundohet të japë përgjigje për një sërë pyetjesh dhe çështjesh të ngritura nga drejtuesit e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit të cilët herë pas here kanë dilemat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në lëndën e TIK-ut.

Udhëzuesi përfshin:

1. Modele të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet lëndës së TIK-ut.
2. Modele të integritit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënësve.
3. Metodologji për zhvillimin e lëndës TIK.
4. Modele të planifikimit kurrikular të lëndës “TIK”:
 - a) Model i planifikimit vjetor.
 - b) Model i planifikimit të periudhës.
 - c) Modeli i planifikimit ditor.
 - d) Model planifikimi të projektit në lëndën “TIK”.
5. Vlerësimi i nxënësve
 - a) Model i vlerësimit të vazhduar.
 - b) Model i vlerësimit të projektit.
6. Modele të detyrës përmbledhëse
 - a) Parimet e hartimit të detyrës përmbledhëse.
 - b) Kriteret që mund të përfshihen në vlerësimin e detyrës përmbledhëse.
 - c) Model detyrës përmbledhëse për një periudhë.

II. RËNDËSIA LËNDËS SË TIK-ut

Lënda e TIK-ut (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) bën pjesë në fushën e të nxënësve “Teknologji dhe TIK”, kjo fushë i aftëson nxënësit të zotërojnë kompetencën digjitale për të

plotësuar interesat e tyre personale, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Ndryshimet teknologjike dhe mënyra e zbatimit të tyre në aspektet e ndryshme të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë po nxisin një ritëm më të shpejtë të ndryshimit, gjë që kërkon përvetësimin e aftësive digjitale në nivele të larta. Këtyre ndryshimeve, arsimi duhet t'u përgjigjet me produkte cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente dhe të qëndrueshme të nxënësit, të cilët garantojnë krijimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë. Është thelbësore që nxënësit të jenë përdorues efektivë të TIK-ut dhe jo përdorues pasivë, duke siguruar njohuri, aftësi dhe qëndrime, të cilat rrisin besimin e nxënësve përgjatë ndërveprimit në një shoqëri që po drejtohet gjithmonë e më shumë nga teknologjia.

Zhvillimi i kapacitetit teknologjik (qëllim kryesor për edukimin digjital) iu mundëson nxënësve të njohin mundësitë profesionale më të kërkuara dhe të shndërrohen në qytetarë të informuar, në një botë që ndryshon shpejt. Të gjithë nxënësit duhet të bëhen pjesëmarrës aktivë në të nxëniet e tyre individual. Ata duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë për të nxëniet vetjak, duke krijuar kështu bazat për të nxëniet gjatë gjithë jetës.

2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxëniet në lëndën e TIK-ut

Programi i TIK-ut ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë, për të siguruar që nxënësit individualisht dhe në bashkëpunim:

- të hetojnë, projektojnë, planifikojnë, menaxhojnë, krijojnë dhe vlerësojnë zgjidhjet;
- të jenë kreativë, inovatorë dhe me iniciativë kur përdorin teknologjitë e reja dhe të kuptojnë se si janë zhvilluar ato me kalimin e kohës;
- të marrin vendime të informuara dhe etike në lidhje me, rolin, ndikimin dhe përdorimin e teknologjive në ekonomi, mjedis dhe shoqëri për një të ardhme të qëndrueshme;
- të angazhohen me besim dhe përgjegjësi që të zgjidhin dhe të manipulojnë me teknologjitë e përshtatshme, materialet, të dhënat, sistemet, komponentët, mjetet dhe pajisjet, kur projektojnë dhe krijojnë zgjidhje;
- të analizojnë, vlerësojnë, kritikojnë problemet, nevojat apo mundësitë për të identifikuar dhe për të krijuar zgjidhje.

Mendimi kompjuterik i nxënësve duhet të zhvillohet gjatë gjithë klasës së 12-të. Ai përfshin këto aftësi:

- zbërthimin (shpërbërjen) - zbërthimin e sistemeve komplekse në sisteme më të vogla dhe më

- të menaxhueshme;
- njohjen e modeleve – kërkimin e ngjashmërive, midis dhe tek problemet;
 - abstraksionin – fokusimin tek informacioni i rëndësishëm duke injoruar detajet e parëndësishme, ose fshehur detajet e implementimit;
 - mendimin algoritmik – zhvillimin e zgjidhjes së problemit hap-pas-hapi, ose hapat e ndjekur për të zgjidhur problemin.

2.2 Risitë e lëndës së TIK-ut

Trajtimi i lëndës së TIK-ut *nëpërmjet kompetencave është risia kryesore e lëndës së TIK-ut*. Zotërimi i TIK-ut nënkupton zotërimin dhe përvetësimin e kompetencës digjitale. Por, çdo të thotë kjo? Në përgjithësi zotërimi i një kompetence (pra të jesh kompetent) në një fushë personale, profesionale apo shoqërore do të thotë të zotërosh në një shkallë të caktuar, modelime të rrethanave në aspekte të ndryshme të jetës në atë fushë. Në këto kushte, zotërimi i kompetencës digjitale do të thotë aftësia për të kuptuar, gjykuar përdorur TIK-un në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh lidhur me botën reale

2.3 Shtrirja e lëndës së TIK-ut

Lënda e TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë zhvillohet në klasën e dhjetë dhe në klasën e njëmbëdhjetë brenda seksionit të kurrikulës bërthamë, përkatësisht me 2 orë në javë për klasën e dhjetë (72 orë vjetore) dhe 1 orë në javë për klasën e njëmbëdhjetë (36 orë vjetore). Gjithashtu lënda e TIK-ut ofrohet si lëndë me zgjedhje në klasën e njëmbëdhjetë me 1 orë në javë (36 orë vjetore) dhe në klasën e dymbëdhjetë me 2 orë në javë (68 orë vjetore).

Programi lëndor i **TIK-ut bërthamë** për **klasën e dhjetë** dhe **njëmbëdhjetë** është i ndërtuar mbi bazën e pesë tematikave:

- Bota e kompjuterit
- Përpunimi digjital i të dhënave
- Programimi në Web
- JAVA
- Programimi dhe algoritmika

Programi lëndor i TIK-ut me **zgjedhje** për **klasën e njëmbëdhjetë** është i ndërtuar mbi bazën e katër tematikave:

- Algoritmika
- Adobe Flash
- Nociione të programimit
- JAVA

Programi lëndor i TIK-ut me **zgjedhje** për klasën e **dymbëdhjetë** është i ndërtuar mbi bazën e pesë tematikave:

- Bota e kompjuterit
- Algoritmikë dhe programimi.
- Bazat e të dhënave dhe menaxhimi i tyre.
- Transmetimi i të dhënave, rrjetat dhe interneti.
- Zhvillimi i aplikacioneve, software-ve dhe sistemeve.

TIK <i>bërthamë</i>	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Programimi në Web	JAVA	Programimi dhe algoritmika	Orë gjithsej
Klasa 10	10 orë	17 orë	16 orë	7 orë	22 orë	72 orë
Klasa 11	6 orë	6 orë	8 orë	4 orë	12 orë	36 orë

TIK <i>me zgjedhje</i>	Algoritmika	Adobe Flash	Nociione të programimit	JAVA	Orë gjithsej
Klasa 11	9 orë	9 orë	9 orë	9 orë	36 orë

TIK <i>me zgjedhje</i>	Bota e kompjuterit	Algoritmikë dhe programimi	Bazat e të dhënave dhe menaxhimi i tyre	Transmetimi i të dhënave, rrjetat dhe internet-i	Zhvillimi i aplikacioneve, software-ve dhe sistemeve	Orë gjithsej
Klasa 12	10 orë	18 orë	14 orë	12 orë	18 orë	72 orë

Programi i lëndës së TIK-ut specifikon peshën (*orët e sugjeruara*) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tematikat janë baza për të siguruar rezultatet e të nxënësve dhe për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë korresponduese të klasës. Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi

lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle. Koha për secilën tematikë, lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si edhe ndarjen e orëve sipas tematikave. Që nxënësit të aftësohen në këtë lëndë, ata duhet të kenë në dispozicion orë që ju mundësojnë praktikimin e njohurive të reja dhe infrastrukturën e përshtatshme në shkollë.

III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE

LËNDORE

Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit. Kompetencat kyç janë ato që i nevojiten një individi për zhvillimin e tij personal, për punësimin, për përfshirjen në jetën sociale si qytetar aktiv, për përshtatjen në botën digjitale.

Zhvillimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies – nxënies nuk është një proces i veçuar, por mësuesi mban parasysh lidhjen e kompetencave kyç, me kompetencat lëndore. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënit, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënit. Kur nxënësi realizon kompetencat e TIK-ut, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç.

Realizimi i kompetencave kyç gjatë procesit të të nxënit kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyç me kompetencat specifike të lëndës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit.

Mësuesi gjatë procesit të planifikimit të periudhave mësimore si edhe planifikimit ditor duhet të jetë shumë i kujdesshëm në përcaktimin e rezultatit/ëve të të nxënit për kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse. Mësuesi duhet t'i përshtasë ato me rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës duke përzgjedhur dhe përdorur përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike dhe metodologjinë e duhur përmes të cilave të realizojë sa më mirë këto rezultate.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave dhe njohurive të marra në lëndën e TIK-ut nuk janë shteruese, ato pasurohen nga vetë mësuesit.

Kompetenca: Hetimi me TIK (Kompetenca e të menduarit dhe e të nxënësit)	
<i>Hetojnë dhe bëhen konsumatorë kritikë të informacionit.</i>	
Nxënësit : <ul style="list-style-type: none"> ▪ zhvillojnë një pamje ueb për website-n e tyre në vijim të strategjive të hulumtuara; ▪ planifikojnë dhe paraqesin kërkime me bibliografi të shënuar; ▪ analizojnë burime informacioni elektronike, kritikojnë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. 	Klasa 10
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ hartojnë një website motor dhe përmirësojnë renditjet e motorëve të kërkimit; ▪ marrin në konsideratë burimet parësore dhe dytësore të kërkimit kur citojnë bibliografitë; ▪ vetëvlerësojnë burimet e veta të informacionit të tilla si website dhe blogje, duke kritikuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. 	Klasa 11
<i>Hetojnë duke përdorur strategjitë dhe mjetet e duhura.</i>	
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ bashkëpunojnë për të zgjidhur problemin dhe konkurrojnë me të tjerët në lojërat interaktive edukative; ▪ punojnë me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të integruar të gjithë anëtarët e komunitetit; ▪ demonstrojnë njohuri për sistemet komplekse pas zgjidhjes së problemit në to si dhe në mjediset stimuluese . 	Klasa 10
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ reflektojnë mbi rezultatet e një loje interaktive edukative ; ▪ identifikojnë strategjitë për sukseset e ardhshme; ▪ krijojnë dhe punojnë me një komunitet online për hulumtim reciprok; ▪ aplikojnë njohuritë e fituara përmes zgjidhjes së problemit në një mjedis simulimi të një konteksti të jetës reale . 	Klasa 11

Kompetenca: Krijimi me TIK <i>(Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin)</i>	
<i>Krijojnë, redaktojnë dhe ndajnë informacion dhe ide.</i>	
Nxënësit : <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë, promovojnë dhe paraqesin një transmetim për një audience të gjerë; ▪ bashkëpunojnë për të planifikuar dhe prezantuar një produkt digjital të rafinuar teknikisht që integron aplikime të përshtatshme të TIK-ut; <ul style="list-style-type: none"> -marrin përgjegjësinë për redaktimin e një elementi të një produkti digjital të prodhuar në bashkëpunim. 	Klasa 10
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë produkte media komplekse, bindëse dhe shumë të individualizuara; ▪ zgjedhin, integrojnë dhe vlerësojnë elemente dhe mjete të projektimit për potencialin e tyre për të arritur efektet e dëshiruara; ▪ demonstrojnë përvoja të specializuara digjitale redaktimi. 	Klasa 11
<i>Bazohen në konventat e njohura për të shprehur ide dhe informacion.</i>	
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ menaxhojnë dhe organizojnë të dhëna duke përdorur mjete të tilla si mail merge; ▪ mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIKut; ▪ përshkruajnë idetë e tyre krijuese dhe hartojnë raportin e tyre në lidhje me pronësinë intelektuale 	Klasa 10
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ për zgjedhin dhe përdorin sisteme menaxhimi të dhënash të përshtatshme për kërkesa specifike; ▪ diskutojnë të ardhmen e projektimit të produkteve digjitale; ▪ shpjegojnë se si të sigurojnë të drejtat ligjore të pronësisë dhe se si të mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale. 	Klasa 11

Kompetenca: Komunikimi me TIK (Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit)	
<i>Shprehin identitetin, komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe ruajnë sigurinë dhe privatësinë.</i>	
Nxënësit : <ul style="list-style-type: none"> ▪ promovojnë respekt për veten dhe të tjerët në komunikime; ▪ diskutojnë sfidat në lidhje me shfaqjen, parandalimin dhe kontrollin e krimit kibernetik; ▪ kuptojnë shqetësimet e paraqitura nga rrjete të veçanta online. 	Klasa 10
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ identifikojnë mënyrat e TIK-ut që mund të përdoren për të promovuar të drejtat e njeriut; ▪ demonstrojnë mirëkuptim të legjislacionit të krimit kibernetik; ▪ krahasojnë dhe vlerësojnë se si rrjete të ndryshme online mbrojnë identitetin . 	Klasa 11
<i>Kontribuojnë dhe mësojnë nga të tjerët.</i>	
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ planifikojnë një projekt këmbimi online, e zbatojnë atë dhe tërheqin pjesëmarrësit në të; ▪ zgjedhin dhe rekomandojnë zgjidhje softuerë bashkëpunuese të përshtatshme për qëllime të veçanta; ▪ bëjnë rekomandime për përdorimin etik të pajisjeve të reja. 	Klasa 10
Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ lehtësojnë punën në grupe me softuerë dhe bashkëpunojnë për të gjetur mjete për menaxhim projekti; ▪ krahasojnë dhe vlerësojnë teknologjitë e reja për ndikimin ndaj çështjeve që ata paraqesin. 	Klasa 11

Kompetenca: Menaxhimi dhe operimi me TIK (Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin)	
<i>Përdor procedurat e njohura për të mbajtur një mjedis TIK të sigurt, të mbrojtur dhe efikas.</i>	

<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përshkruajnë rreziqet specifike të sistemit të tilla si: mosfunksionimi i celularit dhe se si t'i heqin ato ; ▪ krahasojnë sistemet e përbashkëta të lidhjes të tilla si dial-up, ADSL, Wireless Broadband; ▪ analizojnë dhe krahasojnë përgjegjësinë e TIK duke përdorur politikat e organizatave të ndryshme. 	Klasa 10
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë njohuri dhe kuptojnë të rejtat e fundit të sigurisë TIK; ▪ diagnostikojnë defektet kompjuterike, i riparojnë ato dhe përmirësojnë sistemet; ▪ sigurojnë të informohen më këshilla për shëndetin dhe për sigurinë TIK-ut në mjedise specifike. 	Klasa 11
<i>Kuptojnë se si sistemet dhe komponentët TIK janë përdorur për të ruajtur dhe rifituar informacionin.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ bëjnë dallimin ndërmjet funksioneve të sistemeve operative softuerë dhe aplikacioneve softuerë; ▪ përshkruajnë tiparet kryesore të rrjeteve të një sistemi operativ të tilla si kontrollin e aksesit, shërbimet e dosjeve dhe shkëmbimi. 	Klasa 10
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë menaxhim efikas dhe efektiv të skedarëve; ▪ kuptojnë se si një kompjuter kryen logjikën digjitale (duke përdorur sistemin e numrave binarë); ▪ marrin pjesë në hartimin dhe ndërtimin e rrjetit. 	Klasa 11
Kompetenca: Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK <i>(Kompetenca personale dhe kompetenca qytetare)</i>	
<i>Njohin pronësinë intelektuale dhe aplikojnë praktika të sigurisë së informacionit digjital.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ identifikojnë dhe përshkruajnë dilemat etike ; ▪ përdorin një sërë strategjish për sigurimin dhe mbrojtjen e informacionit. 	Klasa 10

<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në mënyrë të ndërgjegjshme aplikojnë praktika që mbrojnë pronësinë intelektuale; ▪ vlerësojnë rreziqet që lidhen me mjediset online dhe krijojnë strategji të përshtatshme të sigurisë dhe kodeve të sjelljes. 	Klasa 11
<i>Aplikojnë protokollet personale të sigurisë dhe identifikojnë ndikimin e TIK-ut në shoqëri.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në mënyrë të pavarur aplikojnë strategjitë e duhura për të mbrojtur të drejtat, identitetin, jetën private dhe sigurinë emocionale të tjerëve gjatë përdorimit të TIK-ut; ▪ vlerësojnë ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri. 	Klasa 10
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përzgjedhin midis protokolleve të përshtatshme për mjete të ndryshme të komunikimit kur bashkëpunojnë me komunitetet lokale dhe globale; ▪ diskutojnë për rolin e TIK-ut në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij 	Klasa 11

IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Ai u shërben të gjitha fushave, duke pasuruar situatat e mësimin në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më tërheqëse. Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqendrohen më gjatë në klasë. Është shumë e rëndësishme që mësuesit e lëndëve të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që nxënësit të kenë mundësinë të krijojnë lidhje analoge midis lëndëve. Madje propozohet që disa projekte kurrikulare të jenë të përbashkëta për disa lëndë. Në këtë mënyrë do të ulej ngarkesa e nxënësve por edhe ata do të aftësoheshin për të zgjidhur një problem nëpërmjet përdorimit të njohurive nga fusha të ndryshme.

1. *Artet*

- Nxënësit hyjnë në një faqe ueb që publikon video si p.sh: YouTube (www.youtube.com). Vendosin 5 video kërcimi në një listë dhe vlerësojnë çdo kërcim duke vendosur yje. Reagojnë

me komente të përshtatshme kritike për çdo klip. Planifikojnë një kërcim në grup. Nën kujdesin e mësuesit kryejnë dhe ngarkojnë kërcimin. Diskutojnë komentet e marra me kalimin e kohës për të përmirësuar performancën në të ardhmen.

- Viziton një studio virtuale muzikore p.sh. BBC One Music. Krijon vija melodike ndërmjet përdorimit të një sekuenciator. Shqyrton punime të ndryshme në industrinë e muzikës.
- Realizon një përmbledhje video të valleve të realizuara nga nxënësit e klasës. Të konsultohen online me “Udhëzues të zgjidhjes së problemeve të videove digjitale” pas kryerjes së një kërkimi dhe ndjekjes së këshillave të tij kur problemet dalin dhe të përpunojnë videon.
- Krijojnë një reklamë për një seri të re produktesh imagjinare që promovojnë mjedis TIK të sigurt, të shëndetshëm dhe komod. Në grupe krijojnë modele të produkteve të paraqitura, një tingull dhe video reklamë. Shikimi i reklamave të prodhuara nga grupet e tjera. Shqyrtojnë kritikën e ndërsjella të reklamave për të rritur aftësitë e tyre që të bindin konsumatorin që të blejë produktet.

2. Letërisa

- Zgjedhin një temë me interes. Kërkojnë në burime të sigurt informacioni artikuj që kanë lidhje me temën mësimore. Zgjedhin disa nga informacionet dhe në mënyrë kritike analizojnë ato. Vlerësojnë faktet e paraqitura dhe komentojnë në lidhje me saktësinë, paragjykimin apo autoritetin e tyre. Redaktojnë artikullin e wikipedia-s nëse kërkohet. Diskutojnë pro dhe kundër ndërtimit të bashkësisë së njohurive.

3. Shoqëria dhe mjedisi

- Shfletojnë artikuj shëndetësorë në faqe me përmbajtje sociale ku informohen me të reja e fundit dhe më të njohura të shëndetit. Regjistrohen si përdorues dhe votojnë artikullin e tyre më të preferuar për shëndetin. Diskutojnë pikëpamjet e tyre rreth artikujve me nxënësit e tjerë të klasës.
- Hartojnë një projekt për mbledhjen e informacionit rreth nxënësve me sjellje të mirë në mjediset online. Studiojnë një grup. Prezantojnë të dhënat e mbledhura Arsyetojnë mbi të dhënat për të identifikuar dhe rekomanduar objektivat e përmirësimit të grupit.
- Zhvillojnë disa njoftime në gazetën ose në website-in e shkollës për të njoftuar prindërit për krimin kompjuterik dhe përshkruajnë hapat që ata duhet të marrin për të mbrojtur veten dhe familjarët.

- Hulumtojnë viruset e aparateve telefonike celulare dhe shkruajnë një ese ku përshkruajnë llojet e viruseve mobile aktuale. Shpjegojnë se si ju mund të mbron pajisjet digjitale.

4. *Matematikë*

- Përdorin programin (Geometer's Schatchpad) për të ndërtuar dhe ndryshuar figurat gjeometrike dhe zbuluar lidhjet dhe teoremat.
- Eksplorojnë mjete online (www.explorellearning.com/) për të përdorur simulimet online për pyetjet matematikore.
- Hulumtojnë dhe krahasojnë rritjen e faqeve të rrjeteve sociale të ndryshme. Paraqesin një tabelë Excel (spreadsheet) për të ilustruar krahasimin e rritjes.
- Bëjnë një produkt digjital për të prezantuar dhe shpjeguar sistemin numerik binar.
- Analizojnë dhe përshkruajnë një gjuhë programimi popullore. Bëjnë një historik të shkurtër se për çfarë ajo është dizajnuar. Përshkruajnë kodin e burimit, algoritmet e specializuar dhe logjikën formale brenda saj. Diskutojnë për rëndësinë e njohjes së gjuhëve të programimit.

5. *Shkencat natyrore*

- Kryejnë një projekt mjedisor me temë të caktuar p.sh:” Ndotja dhe mjedisi”. Përdorin burimet digjitale të ndryshme për realizimin dhe prezantimin e tij.
- Rekomandojnë një zgjidhje për transferimin, ruajtjen, paraqitjen dhe arritjet e një projekti të përfunduar shkencor. Konsiderojnë hard drive-rin, pajisjet e dorës dhe zgjidhjet online. Cila zgjidhje siguron magazinim të sigurt, rikthim të lehtë për ndarjen, përshkrimin e përmbajtjes, datën e krijuar dhe përdorimin minimal të hapësirës.
- Krijojnë produkte digjitale me imazhe dhe tekst që tregojnë marrëdhënien midis shkencave kompjuterike dhe ndërveprimit. Përshkruajnë se si ndërveprimi nxit inovacionin dhe rrit produktivitetin

V. TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. TIK-u ka një shumëllojshmëri zbatimesh në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e dyfishtë sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë

nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave;
- Të drejtat e njeriut;
- Vendimmarrja morale;
- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Mjedisi;
- Ndërvarësia;
- Bashkëjetesa paqësore

Nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë arsyetimin matematikor dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në rritjen e tij personale duke e ndihmuar atë të gjejë vendin e tij në shoqëri. Nxënësi mund të përdorë metodat statistikore (anketa, intervista) për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të arsyetojë dhe të argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin. Nxënësi inkurajohet të veprojë aktivisht në mjedisin e tij duke ruajtur një qëndrim kritik ndaj mallrave të konsumit.

1. Zhvillimi i qëndrueshëm

Mësuesi shpesh shqetësohet pasi nuk është ekspert në çështjet e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe nuk beson se mund të trajtojë lehtësisht çështje të tilla sidomos në temat mësimore që lidhen me zbatimin praktik të TIK-ut. Kjo nuk duhet të jetë një shqetësim për mësuesin, pasi ai mund të integrojë temat ndërkurrikulare në procesin mësimor falë aplikimit të gjerë të TIK-ut në jetën reale.

Shembull

Në një orë mësimi me temë “Teknologjia dhe ne”, mësuesi ndan klasën në grupe, ju tregon nxënësve telefonin e tij celular dhe kërkon që t`ju përgjigjen pyetjeve: “Ku mendoni se është

prodhuar ky telefon? Çfarë do bëj unë me këtë telefon kur ai të priset? etj.” Mësuesi ju jep kohë nxënësve të krijojnë një historik të telefonit të tij dhe ju kërkon të jenë krijues. Më pas mësuesi i vendos nxënësit në grupe të tjera dhe ata krahasojnë përgjigjet e tyre. Mësuesi pyet nxënësit se cili është ndikimi i telefonave celularë ndaj ambientit dhe si mundemi ne ta zvogëlojmë këtë ndikim. Në këtë mënyrë mësuesi ka ndërgjegjësuar nxënësit për ambientin në të cilin jetojmë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke i fuqizuar ata të jenë të aftë të marrin pjesë në diskutime dhe debate dhe të jenë pjesë e zgjidhjeve të problemeve të ndryshme. Pas këtij diskutimi, mësuesi vazhdon me tekstin dhe ushtrimet që janë në libër.

2. Mjedis

Ndikimi dhe rritja në mënyrë progresive e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka prekur çdo aspekt të jetës së përditshme të njeriut duke filluar nga mënyra e komunikimit me njëritjetrin dhe deri te qasjet e ndryshme, të tilla si zhvillimi i produkteve dhe programeve software, të cilat lehtësojnë kryerjen e këtyre aktiviteteve. Masivizimi i produkteve dhe shërbimeve digjitale kohët e fundit ka sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e mjedisit, prandaj është detyra e mësuesit të TIK-ut të ndërgjegjësojë nxënësit lidhur me përdorimin e burimeve digjitale, të cilat garantojnë qëndrueshmëri dhe kanë ndikim të ulët

Shembull

Në temën ndërkurrikulare “Mjedis” mësuesi i TIK-ut mund të përfshijë koncepte të “Green IT” duke shpjeguar rëndësinë e përdorimit të teknologjive miqësore me mjedisin, në mënyrë që të stimulojë përdorimin e mekanizmave dhe strukturave teknologjike që reduktojnë ndikimet negative në mjedis. Mësuesi përgjatë orës së mësimit mund të zhvillojë diskutime me nxënësit lidhur me ndikimin që Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit ka pasur në mjedis dhe se si industria e TIK-ut mund të prodhojë, përdorë dhe riciklojë komponentët hardwerik apo pajisjet periferike. Në mënyrë që të kufizojë ndikimin e dëmshëm në mjedis, duke përfshirë reduktimin e emetimeve të karbonit dhe reduktimin e përdorimit të energjisë elektrike.

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIE – NXËNIES NË TIK

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të

dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie – nxënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat matematikore janë të ndërlidhura, me sinergji dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive, aftësive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në matematikë.

Çfarë dëgjoj, e harroj

Çfarë dëgjoj dhe shikoj, e kujtoj pak

Çfarë dëgjoj, shikoj dhe diskutoj, filloj ta kuptoj

Çfarë dëgjoj, shikoj, diskutoj dhe bëj, fitoj njohuri dhe aftësi

Çfarë i mësoj dikujt tjetër bëhem kompetent.

(Sillberman, 1996)

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë e cila kërkon të japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxisë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Proces i mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënësve*. Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënësve, janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënësve këto metoda.

Mësues të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënësve, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënësve dhe përdorimit të metodave apo teknikave të

mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënësve, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe të të nxënësve. Përmes stileve të të nxënësve mësuesit:

- Ruan *përfshirjen aktive*;
- Nxënësve *diskutim të hapur*;
- Nxënësve të krijojnë dhe *të bëjnë pyetjet e tyre*;
- Ndhmon *shprehjen e mendimeve* të nxënësve;
- Ruan *motivimin* e nxënësve për të mësuar;
- Siguron një mjedis ku *respektohen mendimet*;
- Krijon një shtresë për *reflektim* në atë që nxënësve *vlerësojnë*;
- Shërben si nxitje për *ndryshim*;
- Vendos shpresë për *përfshirjen kritike* të nxënësve;
- Ndhmon *mendimin kritik* në nivele të larta e të ndërlikuara.

Mësimi më efikas dhe afatgjatë ndodh kur mësuesit inkurajojnë zhvillimin e të menduarit në nivel të lartë dhe mendimin kritik, të cilat përfshijnë aplikimin, analizimin, vlerësimin dhe krijimin. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet kujdes zhvillimit të aftësive afektive dhe psikomotorike të nxënësve. Për të siguruar që kjo të ndodhë, ju duhet të inkurajoni njohuri dhe të kuptuar të thellë të përmbajtjes. Teknikat e metodologjisë gjatë procesit të mësimdhënies të prezantuara më poshtë ***nuk janë shtruese***. Mësuesit mund të hulumtojnë dhe të krijojnë vetë teknika të tjera që motivojnë dhe nxisin të nxënësve e nxënësve.

Për të siguruar përdorimin efektiv të TIK-ut mësuesit duhet :

- Të planifikojnë përdorimin e TIK-ut nga ana e nxënësve në bashkëpunim me mësuesit e lëndëve të tjera;
 - Të planifikojnë saktë temat e reja, për të cilat mund të përdoret TIK-u jo vetëm si aftësi kryesore por edhe si aftësi që ndihmon në arritjen e dijeve në lëndët e tjera;
 - Të jenë të sigurt se burimet e TIK-ut janë në dispozicion për mësimdhënien dhe mësimxënien;
- Është e rëndësishme që kur bëhet planifikimi i përdorimit të TIK-ut për temat e reja, të sigurohemi më parë që nxënësve janë në gjendje ta përdorin atë.

Përdorimin e Tik-ut si mjet në orën e mësimit mund ta shohim në disa raste siç po i përshkruajmë më poshtë:¹

1. *Një orë mësimit në laboratorin e kompjuterëve*

Në një laborator kompjuterësh ku mësimit zhvillohet me ndihmën e teknologjisë, nxënësit rrinë para kompjuterëve dhe zhvillojnë veprimtaritë e tyre individuale si: përdorimi i programeve të ndryshme, kërkimi në internet, shkrimi i letrave dhe dërgimi i tyre elektronikisht, punime apo detyra individuale apo bashkëpunim online mes nxënësish. Nëpërmjet kësaj metode realizohet mësimit individual si dhe komunikimi online.

2. *Një orë mësimit në një klasë me disa kompjuter*

Në klasat me disa kompjuter mund të kryhen disa veprimtari. Në këto lloj klasash të organizuara në grupe me nga tri- katër nxënës, komunikimi mësues-nxënës realizohet më lirshëm mes tyre. Ndryshe nga laboratori, nxënësit kanë mundësi të punojnë pa kompjuterin dhe të përdorin atë vetëm kur u duhet ose nëse u duhet. Në këtë mjedis teknologjia shërben si mjet për të zgjidhur llojet e të gjitha detyrave që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e produkteve më të avancuara digjitale. Në këto klasa mësuesit mund t'u japin nxënësve detyra të cilat bëhen me ndihmën e kompjuterit, duke bashkëpunuar me shokët e klasës ose nëpërmjet shkëmbimeve online.

3. *Një orë mësimit në klasa me një kompjuter*

Në disa shkolla ka klasa të cilat janë të pajisura me një kompjuter. Një kompjuter mund të duket i pamjaftueshëm për orën interaktive, por zhvillimi i mësimit me një kompjuter ka disa përparësi:

- Mësuesi menaxhon veprimtarinë e nxënësve në çdo moment;
- Mësuesi kontrollon lehtësisht veprimtarinë e nxënësve duke i udhëzuar ata;
- Teknologjia është në dispozicion në momentin e duhur;
- Nxënësit mund të shohin njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë lirshëm ;
- Duke pasur vetëm një kompjuter në klasë, vëmendja zhvendoset nga teknologjia në mësimit nëpërmjet bashkëpunimit;

Përdorimi i TIK-ut në mësimit rrit cilësinë e mësimit dhe paraqet një strategji mjaft të rëndësishme për asimilimin e njohurive dhe ofron mundësi për përmirësimin e sistemit arsimor.

Për këtë arsye, rekomandohet aplikimi i metodave të reja të mësimit dhe nxënies duke integruar TIK-un në procesin vetëm në orët kur shikohet e arsyeshme. Për të realizuar orë të tilla nevojiten këto pajisje:

¹ Universiteti Sh.Kirili Fakulteti Pedagogjik, Shkup, fq. 16

- Kompjuter
- Printer
- Video projektor
- Rrjete kompjuterike lokale
- Instalim interneti
- Software për të gjitha lëndët që dëshirojnë të përdorin TIK-un
- Laboratorë virtual....etj..

Në këto cikle shkollimi është shumë i rëndësishëm fakti që jo të gjithë nxënësit mësojnë njësoj. Për këtë arsye, në këtë kapitull i japim rëndësi inteligjencave të shumëfishta që ndikojnë në përvetësimin e njohurive nga ana e nxënësve.

Inteligjencat e shumëfishta

Howard Gardner ka propozuar një teori për inteligjencat e shumëfishta dhe mësuesit në çdo nivel klase.

Ai sugjeron që inteligjenca i referohet aftësisë së njerëzve për të zgjidhur problemet ose për të bërë diçka të vlerësuar në një kulturë të caktuar (Checkley, 1997). Në librin e tij *Frames of Mind* (1983), Gardner, propozon që kultura jonë ka për ta përcaktuar ngushtë inteligjencën dhe që faktikisht ka të paktën shtatë inteligjenca bazike. Teoria e tij njihet si teoria e inteligjencave të shumëfishta (teoria MI). Gardner gjithashtu sugjeron që inteligjenca ka të bëjë më tepër me kapacitetin për të zgjidhur probleme dhe për ti dhënë formë produkteve se sa me detyrat e izoluara të testeve të IQ.

Armstrong (1994,) sugjeron katër pika kyçe në teorinë MI (multiple inteligencis):

1. Çdo person posedon plot tetë inteligjenca. Disa njerëz kanë nivel të lartë të funksionimit të pjesës më të madhe të inteligjencave: disa të tjerë janë më të zhvilluar në një ose dy inteligjenca dhe më modest ose më pak të zhvilluar në inteligjencat e tjera.
2. Pjesa më e madhe e njerëzve mund të zhvillojnë secilën inteligjencë në një nivel të përshtatshëm kompetence.
3. Inteligjencat zakonisht veprojnë së bashku në mënyra komplekse. Inteligjencat ndërveprojnë dhe mbështesin njëra tjetrën.
4. Ka shumë mënyra për të qenë inteligjent në secilën kategori. Nuk ka një set standard karakteristikash, cilësish, ose attribute që një person duhet të ketë për të qenë inteligjent në një fushë të caktuar.

Gardner nuk mbron një mënyrë të vetme të mësimit dhe nuk beson se ka një plan për mësimdhënien (Checkley, 1997). Ai beson që teoria MI, mbasi kuptohet, inkurajon mësuesit të marrin parasysh ndryshimet individuale dhe ti ndihmojnë të gjithë fëmijët ta përdorin mendjen e tyre mirë (Checkley, 1997). Për aplikimin e modelit MI në klasë, mësuesit largohen nga format tradicionale të mësimdhënies, duke përfshirë shpjegimin dhe kërkimin nga studentët për detyra të shkruara dhe punime. Në termat e vlerësimit Gardner mbron idenë që mësuesit duhet të lejojnë nxënësit të demonstrojnë të kuptuarin në një shumëllojshmëri mënyrash (Checkley, 1997).


Kur mësuesit aplikojnë modelin MI në mësimdhënien e tyre, sugjerohet që ata të mendojnë për inteligjencat dhe se si ato mund të integrohen në mënyrën e duhur në një kapitull ose mësim të veçantë, duke mundësuar një balancë ndërmjet tërë inteligjencave në aktivitete. Duke vepruar kështu, të gjithë nxënësit mund të kenë inteligjencën e tyre më të fortë të përfshirë disa herë në kohë. Armstrong (1994, fq. 58) sugjeron që, nëse njëherë të vetme objektivi i një kapitulli ose mësimi është në mëndje, mësuesit mund të bëjnë pyetjet e mëposhtme për të adresuar tërë inteligjencat:

- 1. Logjike- Matematikore:** Si mund të paraqes numrat, llogaritjet, klasifikimet logjike ose të menduarin kritik?
- 2. Gjuhësore:** Si mund ta përdor fjalën e shkruar apo të lexuar?
- 3. Hapësinore:** Si mund ta përdor ndihmën vizuale, vizualitetin, ngjyrat, artin apo metamorfozën?
- 4. Muzikore:** Si mund të paraqes muzikën ose tingujt e ambientit, ose të caktoj pika kyçe në një ritëm ose strukturë melodike?
- 5. Trupore-Kinesthetic:** Si mund të përfshij të gjithë trupin ose përdor eksperiencat konkrete?
- 6. Natyraliste:** Si mund ta përdor ambientin jashtë?
- 7. Ndërpersonale:** Si mund ti angazhoj studentët në shkëmbimin në çift, mësimin bashkëpunues ose simulimet në grupe të mëdha?
- 8. Intrapersonal:** Si mund tu shkaktoj ndjenja personale apo kujtime ose tu jap studentëve mundësi zgjedhjeje?

Duke marrë në konsideratë për sa i përket më lart, disa teknika interaktive që mund të përdorin mësuesit në lëndën e TIK-ut janë :

BRAINSTROMING

Brainstorming (stuhi mendimesh) është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të mendojnë rreth një çështje dhe të diskutojnë rreth saj me synim ndërtimin e njohurive të reja. Kjo teknikë, siguron një mjedis të lirë dhe të hapur që inkurajon të gjithë pjesëmarrësit për të shprehur në mënyrë kreative mendimet e tyre rreth një problemi. Teknika (brainstorming) përdoret në fazën fillestare të ndërtimit të njohurive të reja. Në këtë fazë, mësuesi udhëzon nxënësit të listojnë të gjithë njohuritë që ato kanë lidhur me temën e re. Në këtë fazë, roli i mësuesit është të drejtojë debatin, të kuptojë mendimet e nxënësve dhe të dëgjojë me kujdes idetë e tyre. Përdorimi i kësaj teknike synon pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor. Brainstorming është një teknikë e thjeshtë dhe e efektshme e cila kërkon një nivel të lartë krijimtarije për tu përdorur. Këtë teknikë mësuesit e TIK-ut mund ta përdorin gjatë kohës që ata zhvillojnë kryesisht tematikën e Internetit si dhe atë të prezantimit digjital. Gjithashtu mësuesit gjatë tematikës së prezantimit digjital, mund tu kërkojë nxënësve të realizojnë prezantime duke përdorur programe të ndryshme multimediale dhe më pas tu kërkojë nxënësve se nga ndryshojnë ato nga njëri-tjetri.



HARTA E KONCEPTVE (KONCEPTOGRAMA)

Harta e koncepteve (konceptograma), është një metodë (teknike) e paraqitjes vizuale të një informacioni dhe shërben për lidhjen e koncepteve të një teme mësimore, disa temave apo të një

tematike. Përcaktimi me saktësi i kësaj metode (teknike,) mundëson qëndrueshmëri në përvetësimin e njohurive, integrimin logjik dhe aftësinë për zbatimin e tyre, si dhe shprehinë e një pune krijuese. Konceptograma shërben si një instrument diagnostikues i procesit të të nxënit interaktiv. Konceptogramën mund ta ndërtojme edhe duke filluar nga një koncept specifik dhe të kalojmë te koncepti themelor. Ato mund të jenë dy llojesh: të thjeshta, ose të detajuara në degë hierarkike. Elementët përbërës të tyre janë: etiketat, vijat dhe nyjat.

Në etiketa vendosen konceptet, vijat lidhin konceptet dhe përcaktojnë tipin e strukturës së konceptogramës.

Konceptograma zbatohet lehtë në kushtet e mjedisit të një klase. Mësuesi udhëzon nxënësit hap pas hapi duke mbajtur shënime në tabelë dhe pasi dëgjon mendimet e tyre, bën vërejtjet përkatëse dhe ndërton një konceptogramë, duke u bazuar në idetë më të mira të nxënësve. Më poshtë po listojmë veprimet që kryen mësuesi gjatë një ore mësimore:

- Mësuesi liston në një tabelë përmes diskutimit me nxënësit të gjitha konceptet që përmban tema apo tematika.
- Ai ndërton së bashku me nxënësit diagramin e konceptogramës duke vendosur konceptet në etiketa.
- Vendos konceptin më të përgjithshëm në qendër dhe e rrethon atë.
- Pyet nxënësit se cilat janë konceptet e tjera, që lidhen me konceptin e vendosur te etiketa qendrore.
- Bashkon etiketat me vija të thjeshta ose vija me shigjeta sipas kontekstit të përmbajtjes së tyre.
- Mund të udhëzojë nxënësit që të ndarë në grupe të ndërtojme secili nga një konceptogramë. Në fund të kohës së caktuar, mësuesi kontrollon konceptogramet dhe ndërton një konceptogramë duke debatuar dhe bërë komentet e duhura me nxënësit për problematikat ose logjikën e ndjekur nga ana e tyre.

Në lëndën e TIK-ut nxënësit e klasës së 8-të dhe të 9-të mund të krijojnë lehtësisht hartat e koncepteve nëpërmjet programit Prezi ose nëpërmjet programeve dhe aplikacioneve të specializuara siç është p.sh.: MindView.

Në këtë skemë mësuesi duhet të bëjë ndarjen e variabëlve para se të fillojë kodimin.

Udhëzime për përdorimin e saj në klasë

- Shkruani në tabelë të gjitha konceptet e reja të një tematike.

- Ndërtoni etiketat, ku në secilën prej tyre keni të vendosur nga një koncept.
- Vendosni etiketat sipas një rregulli logjik.
- Bashkoni me vija konceptet që lidhen me njëri –tjetrin.


DIAGRAMA E VENIT

Diagrama e Venit është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to. Veprimtaria zgjat 10'-20', por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.

Shembull:

TIPOLOGJIA BUS

TIPOLOGJIA RING



DEBATI

Debati është një metodë që karakterizohet nga një procedurë formale për paraqitjen e argumenteve për një çështje, nga dy grupe kundërshtarë, para dëgjuesve duke ndjekur një ecuri standard. Njëri prej grupeve është pro problemit, tjetri kundër. Për të zhvilluar një debat është e domosdoshme të kesh një problem, dy skuadra debatuesish dhe një procedurë për të debatuar çështjen. Debati të jep mundësi të flasësh, të pyesësh dhe të përgatitësh argumentet.

Kjo metodë/teknikë mund të përdoret në klasë me grupe të mëdha ose të vogla nxënësish. Në të dyja rastet, debati është më mirë të fillojë me anë të një diskutimi të shkurtër të çështjeve të përfshira në temën e debatit. Kjo ofron një kontekst për debat, një kuptim të nën-çështjeve të përfshira, dhe mat dijet që ka klasa rreth kësaj çështje. Në këtë kohë, mësuesi duhet të bëjë të qartë rregullat e debatit, duke përfshirë kohën e caktuar për secilin grup dhe rregullat për të folur. Pasi palët dhe zgjedhja është vendosur, nxënësve do t'ju duhet kohë për të përgatitur argumentet dhe strategjitë e tyre.

Nëse klasa është pro kryerjes së një debati si një grup i madh, atëherë, mësuesi shërben si moderator. Në formate të vogla (*secila skuadër përbëhet nga dy ose tri debatues*) ose grupe të mëdha, nxënësit duhet të udhëzohen të argumentojnë pikëpamjet e tyre pro ose kundër mbështetur në burime, në varësi të objektivave të mësuesit. Mësuesi gjatë zhvillimit të debatit vendos vëzhgues si gjykatës dhe i udhëzon ata si duhet të procedojnë në një debat. Po ashtu vendos vëzhgues të tjerë si matës të kohës. Për ti bërë vëzhguesit sa më aktiv, mësuesi i nxit ata për ti shtuar debatit çështje të tjera të cilat nuk janë prekur nga grupet debatuese.

Debati ka një drejtues, i cili prezanton temën dhe folësit, pasi debate ka mbaruar moderatori mund të drejtojë një diskutim të hapur në të cilin ndjekësit e debatit mund të shprehin mendimet e tyre ose të drejtojnë pyetje.

Debatuesit bëjnë një paraqitje formale dhe argumentojnë çështjen brenda kohës së caktuar. Ai që shënon kohën (vëzhguesi), kujdeset për respektimin e kohës së përcaktuar për secilin debatues. Mësuesi i jep përparësi grupit të nxënësve që përpilon arsyetime të bazuara në prova dhe argumente konkret brenda kohës së përcaktuar.

Disa mësues preferojnë ta përmbledhin debatin në fund, kjo për të sqaruar informacionin e paraqitur që nxënësit të përqendrohen drejtpërdrejt tek pikat kyçe që rrjedhin nga debati.

Mësues të tjerë, përmbledhin kontributet e nxënësve duke ruajtur shumëllojshmërinë e mendimeve dhe perspektivave të cilat dalin gjatë debatit.

Udhëzime për përdorimin e saj në klasë

- Zgjidhet çështja që do të debatohet.
- Ndahet klasa në dy skuadra.
- Drejtuesi paraqet temën e debatit, grupet, atë që do të mbajë shënimin kohën dhe vlerësuesit.

- Secila skuadër bën një paraqitje formale të çështjes brenda kohës së caktuar.
- Secila skuadër kundërshton argumentet e skuadrës tjetër.

Tematika për debat:

- *Gjuhët e programimit: Avantazhet dhe disavantazhet e secilës*
- *Zhvillimi i konceptit të mendimit kompjuterik në ditët e sotme*
- *Me dhe pa kompjuter për të zhvilluar mendimin algoritmik*

PROJEKTI KËRKIMOR

Projekti kërkimor është vlerësuar si metodë tepër pretenduese, realizimi i së cilës kërkon praktikimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: intervista, vrojtimi, studimi rasti, dhe pse jo, kombinimin e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Për të realizuar këtë teknikë mësuesi duhet tu lërë nxënësve në dispozicion disa orë mësimore. Kjo teknikë mund tu propozohet nxënësve për realizimin e një projekti lëndor, të cilit mësuesit mund ti lërë në dispozicion disa orë të periudhës. Nuk duhet që orët të jenë orë që realizohen në klasë, ato mund të jepen në formën e detyrave të shtëpisë. P.sh: kur nxënësit kanë për të trajtuar **temën e Internetit të sigurt**, ata mund të marrin në intervistë nxënësit më të rritur, prindërit apo edhe mësuesit. Më pas të analizojnë të dhënat që do të dalin nga intervistat dhe më pas, duke i diskutuar në klasë, të shohin se sa këto të dhëna përputhen me njohuritë lëndore.

Udhëzime për përdorimin e saj:

- Kërkohe të shfrytëzohet informacioni dhe njohuritë e nxënësit nga më shumë se një lëndë.
- Është metodë që vë në përdorim dhe shfrytëzon përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e tyre të marra nga burime jo shkollore.
- Si metodë kërkon që shumë nga veprimtaritë e nxënësve të kryhen jashtë orës së mësimit dhe jashtë mureve të shkollës.
- Projekti kërkimor kërkon përcaktimin e partnerëve pjesëmarrës në arritjen e objektivave. Partnerët mund të jenë mësues të lëndëve të tjera, prindër dhe përfaqësues të komunitetit.

PUNA ME GRUPE TË VOGLA

Instrukcioni i dhënë për të gjithë klasën ndodh kur mësuesit i paraqesin të gjithë klasës një temë dhe kanë bërë disa ndryshime në përmbajtje ose në vlerësim në bazë të aftësisë personale të çdo nxënësi.

- Qëllimi i instruksionit të dhënë për të gjithë klasën është se të gjithë nxënësit kanë nga një detyrë të përcaktuar për të mësuar përmes së cilës ata fitojnë ose/dhe praktikojnë mësimin.
- Instruksionet duhet të jenë të kuptueshme për të gjithë nxënësit. Niveli i të mësuarit më pas vlerësohet duke përdorur metoda standarde si p.sh. vlerësimi verbal ose joformal.
- *Diskutimi me gjithë grupin* është një formë e modifikuar e mësimdhënies për të transferuar informacion dhe është e përqendruar mbi instruktorin dhe nxënësin.
- Sipas metodologjisë tipike, instruktori ri qëndron përpara klasës dhe i bën një prezantim nxënësve, nga ana tjetër, nxënësit gjithashtu marrin pjesë duke ju përgjigjur pyetjeve dhe duke dhënë shembuj.

Përdorimi i punës në grup është metodë e rëndësishme në matematikë sepse nxënësit mësojnë nga njëri – tjetri.

Për të vendosur nëse do të përdorni punë në grupe apo jo, duhet të keni parasysh:

- rezultatet e të nxënit që synoni të arrini;
- shkalla në të cilën rezultatet e të nxënit mund të arrihen në një grup;
- përmbajtjen e mësimit;
- kohën e caktuar për përfundimin e detyrës në grup;
- vendosjen e nxënësve në klasë;
- burimet në dispozicion;
- struktura e grupit në bazë të aftësisë apo preferencave të studentëve.

Grupet punojnë mirë, kur:

- grupi vendos vetë mbi qëllimin, afatet dhe detyrat e anëtarëve të grupit;
- nxënësit kuptojnë se suksesi varet nga arritja e grupit dhe jo individit;
- detyra e grupit ndahet në nëndetyra, të cilat duhet të përfundojnë me sukses për të plotësuar detyrën e përgjithshme;
- secili ka një rol për të luajtur;
- anëtarët e grupeve ndryshohen rregullisht për të siguruar një shumëllojshmëri të të nxënit për të gjithë nxënësit;

Strategjitë për organizimin dhe menaxhimin e grupeve:

- grupe me aftësi të përziera - nxënësit më të aftë në grup mund të ndihmojnë të tjerët për të kryer punën në mënyrë që ju të lehtësoheni nga shpjegimi i detyrave;

- grupe me aftësi të njëjta - nxënësit më të shkathët mund të punojnë me nxënësit më të ngadalshëm për të ndihmuar me punë shtesë për përmbushjen e detyrës;
- përdorni drejtuesit e grupit - mund të caktoni ju ose nxënësit një drejtues i cili është organizator i mirë i detyrave të grupit dhe i aftë në mënyrë që të ndihmojë nxënësit e tjerë.

DISKUTIMI

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive mësimore kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi fillon në çastin kur nxënësit drejtojnë pyetje dhe kur një nxënës përgjigjet për atë që ka thënë një nxënës tjetër. Pra, kjo ***metodë është një përzierje e shpjegimeve mësues-nxënës, nxënës-nxënës dhe shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre.***

Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e TIK-ut. Kur mësuesi vendos të organizojë diskutimin në klasë merr parasysh dy momente vendimtare:

- *E para*, mënyrën e sistemimit të klasës, aty ku është e mundur. A është i përshtatshëm vendi për organizimin e nxënësve, aq sa ata të shohin dhe të dëgjojnë njëri tjetrin?
- *Së dyti*, deri në ç’masë dhe gjerësi mësuesi ka ndërmend të drejtojë diskutimin? Udhëheqja e tij kontribuon në forcimin e rrjedhshmërisë së mendimit dhe zhvillimin e asaj që është thënë.

Për mësuesin dhe nxënësit është shumë e rëndësishme që të ketë një atmosferë të respektit reciprok gjatë zhvillimit të diskutimit. Për këtë arsye nxënësit bashkë me mësuesin që në fillim të vitit vendosin “rregullat e diskutimit”, në mënyrë që të kenë një diskutim të hapur dhe të vërtetë.

Duke e parë diskutimin në lidhje me shkallën e kontrollit nga ana e mësuesit, ekzistojnë disa lloje të tij:

- Diskutimi rreth pyetjeve të strukturuar dhe të drejtuara nga mësuesi.
- Diskutimi rreth pyetjeve gjysmë të strukturuar, gjatë të cilit nxënësit nxiten të tregojnë shkallën e të kuptuarit të koncepteve të rëndësishme.
- Diskutimi reflektiv që nënkupton një sërë çështjesh pak të strukturuar. Nxënësit në këtë rast mendojnë në mënyrë kritike për zgjidhjen e problemeve.
- Diskutimi në grupe të vogla. Klasa ndahet në grupe të vogla të cilat kanë përgjegjësi të caktuara në diskutim.

Avantazhet	Kufizimet
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillon aftësitë komunikuese të nxënësve. ▪ Rrit motivimin e nxënësve. ▪ Aftëson nxënësit të marrin pjesë konstruktive në diskutim dhe si të bashkëpunojnë me njëri - tjetrin. ▪ Aftëson nxënësit të bëjnë përgjithësime, analogji, të gjykojnë përparësitë, të krahasojnë dhe të kundërshtojnë argumentet. ▪ Aftëson nxënësit të jenë këmbëngulës në arritjen e një objekti të caktuar dhe në zgjidhjen e një problemi. ▪ Aftëson nxënësit të përfitojnë nga diskutimi, nga informacionet që merren dhe nga këndvështrimet që trajtohen. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në qoftë se nuk planifikohen mirë pyetjet që do të drejtohen dhe si do të pasojnë njëra tjetrën, mund të ketë shmangie nga tema dhe jo një diskutim të vërtetë. ▪ Në qoftë se nuk planifikohet mirë mund të kthehet në stërmundim. ▪ Krijon mërzi, në qoftë se procesi është i gjatë.

PYETËSOR OSE STUDIM ÇËSHTJEJE

Kjo teknikë ndihmon nxënësin të formulojë pyetjet dhe të mbledhë informacionin e duhur, duke nxitur pavarësinë dhe autonominë e tij në procesin e të nxënësve. Gjithashtu kjo teknikë ndihmon krijimtarinë dhe bashkëveprimin midis nxënësve.

- a. Mësuesi shpjegon informacionin që do të mblidhet.
- b. Nxënësit individualisht, në çift ose në grup, hartojnë pyetjet e pyetsorit për të mbledhur informacionin që u duhet
- c. Të dhënat e pyetësorit përpunohen në klasë.
- d. Rezultatet diskutohen në klasë.

STUDIMI I RASTIT

Përfaqëson një formë të veçantë të zgjidhjes së problemit, e cila konsiston në studimin e hollësishëm të një rasti apo situatë të veçantë, të një institucioni, vendimi apo çështjeje për të cilën nxënësit bëjnë përgjithësime.

DITARI DYPJESËSH.

Në këtë metodë nxënësit reflektojnë ndaj asaj, që lexojnë dhe më pas duke zgjedhur një fragment nxënësit shprehen pro ose kundër fragmentit, shtojnë diçka nga përvoja e tyre ose formulojnë pyetje.

KUBIMI

Nënkupton shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme. Nxënësit përshkruajnë, shoqërojnë, analizojnë, zbatojnë dhe argumentojnë kërkesa të cilat janë në përputhje me nivelet e të nxënit.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT

Një letër e palosur si fizarmonikë, e cila plotësohet duke kaluar nga një nxënës tek tjetri, sipas një kahu lëvizjeje të caktuar dhe asnjë nxënës nuk e di se çfarë ka shkruar paraardhësi.

KLLASTERI.

Gjatë kësaj teknike ndërthuret të lexuarit me të shkruarit. Nxënësve u kërkohet të shkruajnë rreth një teme, idetë e të cilëve shpalosen, duke krijuar më pas lidhje të njohurive me njëra tjetrën.

ZHVILLIMI I AFTËSIVE TË TË MENDUARIT KRITIK DHE KRIJUES

Programi i TIK-ut synon zhvillimin tek nxënësit i aftësive të të menduarit kritik dhe krijues. Të menduarit kritik është përdorimi i arsyes për të marrë një vendim a për të formuar një opinion dhe përbën një aftësi të rëndësishme në studimin e lëndës së biologjisë. Zotërimi i koncepteve digjitale në lidhje me aftësimin për të analizuar, për të vlerësuar dhe për të arsyetuar është, gjithashtu, mjaft e rëndësishme në aftësimin e nxënësve drejt përdorimit të njohurive digjitale në praktikën e përditshme jetësore. Veprimtaritë mësimore që lidhen me klasifikimin, vendosjen e lidhjeve ndërmjet pjesëve, nxjerrjen e ngjashmërive dhe të dallimeve shërbejnë si modele që ndikojnë në zhvillimin e aftësive analitike të të menduarit kritik. Ndërsa induksioni dhe deduksioni bëjnë të mundur të përdoren konceptet në situata konkrete, për të shpjeguar dukurinë. Më specifikisht në lëndën e TIK-ut duhet marrë në konsideratë:

- Përqëndrimi në një numër të vogël konceptesh, por duke i trajtuar në thellësi.
- Zbatimi në praktikën e mësimdhënies i një shumëllojshmërie strategjish, bazuar në faktin se stilet e të nxënit janë të larmishme. Nxënës të ndryshëm nxënë në mënyra të ndryshme, disa nxënë duke lexuar, disa duke dëgjuar, disa duke punuar praktikisht në laborator, të tjerë përmes kryerjes së detyrave të tekstit, etj.

- Paraqitja e njohurive bazë biologjike nga këndvështrime të ndryshme.
- Nxitja e diskutimit, punës së pavarur, punës së udhëhequr dhe punës në grupe të nxënësve.

ZGJIDHJA PROBLEMORE

Aftësia e zgjidhjes problemore është një nga aftësitë e rëndësishme që duhet formuar gjatë zhvillimit të programit të biologjisë. Për të mësuar nxënësit të zgjidhin problemet, është e domosdoshme t'i nxisim ata të mendojnë rreth metodës së zgjidhjes së problemeve. Ndër strategjitë që mundësojnë përgatitjen e nxënësve për zgjidhjen e problemeve, sugjerohet:

- Të trajtohen më parë njohuritë dhe konceptet bazë të TIK-ut, të mbahet parasysh përforcimi dhe monitorimi për shkallën e përvetësimit të tyre dhe pastaj të kalohet në zgjidhjen e problemeve që lidhen me to.

Të trajtohet metodika e zgjidhjes së problemeve. Për këtë të bëhet orientimi i nxënësve në ndjekjen me radhë të hapave metodikë të zgjidhjes së problemeve:

- 1) përcaktimi i qartë i të dhënave nga kushtet e detyrës dhe kërkesat e problemit;
- 2) kryerja e veprimeve të nevojshme për të marrë përgjigjen e kërkuar nga problemi.

Një tjetër aspekt i zhvillimit të aftësisë së zgjidhjes problemore tek nxënësit është këndvështrimi i zgjidhjes së problemeve praktike të jetës së përditshme, të cilat kanë lidhje me njohuritë dhe aftësitë digjitale.

Një teknikë veçanërisht e përshtatshme për mësimdhënie – nxënie në lëndën e TIK-ut është zgjidhja problemore. Për pjesën më të madhe të njerëzve (përfshirë mësuesi, nxënësit, prindërit e tyre etj.), çdo ditë është e mbushur me probleme për t'u zgjidhur, pengesa për të kapërcyer. Sipas studiuesve problemet shfaqen në tri lloje: analitike, krijuese dhe praktike.

- **Problemet analitike** janë tipi më i zakonshëm i problemeve dhe janë tipike për shkollat. Në këto lloj problemesh nxënësit përdorin aftësitë analizuese, sintetizuese, identifikimi shkak-pasojë, vlerësimi duke kaluar nëpër të gjitha fazat e zgjidhjes së problemeve.
- **Problemet krijuese** nuk kanë një zgjidhje/përgjigje të vetme. Ato përfshijnë aftësi dhe procese të tjera si: përfytyrimi, shpikja, projektimi, hartim hipotezash etj. Ky tip problemash **duhet të zërë më shumë vend në shkollat tona** sepse zhvillon shprehi jetësore si dhe zhvillon aftësi për zgjidhje të problemeve që nuk ekzistojnë tani (sot), por që mund të ekzistojnë në të ardhmen e nxënësve.
- **Problemet praktike** i kërkojnë nxënësve të zgjidhin probleme në rrethana të jetës së përditshme. Ata duhet të lidhin problemin me situata nga jeta e tyre dhe bota që i rrethon. Në

këtë mënyrë ata motivohen më shumë dhe fitojnë shprehi për të zgjidhur probleme të kësaj natyre kur të gjenden në jetën reale apo në karrierën e tyre të ardhshme.

Hapat për zgjidhjen problemore

Hapat për zgjidhjen problemore mund të përdoren për të tre tipet e problemeve. Është e rëndësishme që nxënësi t'i marrë në shqyrtim kur përballet me probleme, vështirësi, pengesa apo situata të ngatërruara. Secilit hap i është vënë një numër, sepse jo të gjitha problemet janë lineare, ato janë ciklike. Për shembull një zgjidhje e mundshme në hapin e katërt, mund ta çojë nxënësin përsëri në hapin e dytë apo zgjidhja e mirë në hapin e pestë mund ta çojë nxënësin në përkufizimin e një problemi të ri.

MENDO-DISKUTO NË ÇIFT

Nxënësi ka mundësi të reflektojë mbi pyetjen e bërë, konsulton, jep dhe merr zgjidhje me shokun e bankës mbi përgjigjet e mundshme. Thjeshtësia e aplikimit të saj u ofron mësuesve një integrim të lehtë në të mësuarin në

bashkëpunim të të gjithë nxënësve për klasa me numër të madh nxënësish. Mendo-diskuto në çift mund të përdoret për të nisur zgjidhjen problemore.

INSERT

Zbatimi i kësaj teknike përshin tre etapat e orës mësimore. Gjatë *fazës së parë të orës mësimore* para dhënies së tekstit për lexim, pjesëmarrësit udhëzohen që gjatë leximit, në fund të fjalisë apo paragrafit në të cilin tregohet diçka duhet të vendosen shenja. Përgjatë *realizimit të kuptimit* nxënësit i jepet për lexim teksti. Në etapën e tretë, atë të *përforcimit të njohurive* pjesëmarrësit në çifte diskutojnë çfarë lexuan, bisedojnë për informacionet e reja, krahasojnë shenjat etj. Në mënyrë individuale radhitet informacioni në bazë të shenjave, kështu ndërtohet tabela e insertit. Nëse reflektimi mbulohet me diskutim rreth temës, tabela e insertit mund të jepet si detyrë shtëpie.

Pasi nxënësit lexojnë tekstin duke e ndarë atë në paragrafë, mësuesi e plotëson tabelën Insert me ndihmën e tyre.

√	+	-	?
Kontrollo të dhënat që di	Shkruaj të dhëna të reja	Të dhëna që kundërshtojnë ose janë të ndryshme	Të dhëna të paqarta ose kërko të dhëna shtesë

.....
.....

“DI – DUA TË DI – MËSOVA”

Sipas kësaj teknike nxënësi plotëson kolonat e tabelës “Di”, “Dua të di”, “Mësova” përgjatë tri fazave kryesore të orës së mësimi.

Di	Dua të di	Mësova
Mësuesja pyet nxënësit për njohuritë që kanë për planetët dhe i shkruan në tabelë.	Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë paragrafin e tekstit që flet për temën mësimore dhe u thotë atyre të tregojnë se çfarë mësuuan nga teksti. Në këtë pjesë table shkruhen njohuritë që nxënësit lexuan për konceptet e reja.	Mësuesja orienton diskutimet bazuar në njohuritë që kishin nxënësit dhe ato që mësuuan nga leximi i tekstit dhe shpjegon mësimin duke u bazuar edhe në materiale shtesë rreth temës si ps.sh. (video tutoriale, materiale ndihmëse, të dhëna nga interneti etj..)

Teknologjitë edukative të mësimdhënies kanë evoluar me një shpejtësi marramendëse drejt përfshirjes së mjeteve digjitale në procesin mësimor. Interneti është një burim i dobishëm informacioni për shumë tema dhe një mjet komunikimi me njerëzit. Nxënësi duhet të përdorë aftësi specifike të nevojshme për të hyrë në informacion në internet dhe më shumë e rëndësishme është vlerësimi në mënyrë kritike e informacionit të grumbulluar. Përdorimi i programeve dhe aplikacioneve të ndryshme në mësimin e koncepteve të TIK-ut është shumë i rëndësishëm. Përdorimi i teknologjisë mbetet gjithmonë një sfidë për mësuesit dhe nevoja për të zotëruar mësimdhënien online është bërë thelbësore. Është shumë e rëndësishme që mësuesit, të cilët nuk janë ende në gjendje të përdorin teknologjinë të motivohen në kërkimin dhe përdorimin e burimeve online në celularë (laptop apo tableta) në mënyrë që mësimdhënia e gjuhëve të jetë efektive për

nxënësit. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të përdorin burime si: faqe të internetit, blogje dhe mjete digjitale të cilat i ndihmojnë ata të kalojnë me sukses nga mësimi i drejtpërdrejtë në klasë në mësimin online (ose të kombinuar), si dhe të përshtasin ekspertizën e tyre me situatën aktuale.

VII.PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënësve janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

7.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën ose modulën përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të lëndës.

7.2 Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohet në vazhdim. Shpërndarja e përmbajtjes kryesore së lëndës sipas tri periudhave, bëhet në këtë kolonë ku vendosen përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihet njohuri, projekte, , detyra përmbledhëse etj..., në varësi të specifikave të lëndës.

Modele sugjeruese të planifikimit vjetor në lëndën e TIK-ut, klasa X

TIK <i>bërthamë</i>	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Programimi në Web	JAVA	Programimi dhe algoritmika	Orë gjithsej
Klasa 10	10 orë	17 orë	16 orë	7 orë	22 orë	72 orë

TEMATIKAT	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	SHTATOR-DHJETOR 28 orë	JANAR-MARS 24 orë	PRILL-QERSHOR 20 orë
		20 orë teori 5 orë veprimtari praktike 1 orë projekt 1 orë përsëritje 1 orë detyrë përmbledhëse	17 orë teori 3 orë veprimtari praktike 1 orë projekt 2 orë përsëritje 1 orë detyrë përmbledhëse
Bota e kompjuterit (10 orë)	1.1 vlerësojnë tipat e ndryshme të kanaleve të transmetimit; 1.2 interpretojnë terminologjinë bazë të kompjuterit; 1.3 njohin komponentët e rrjetit.		
Përpunimi digjital i të dhënave (17 orë)	2.1 vlerësojnë produktet; 2.2 përdorin wizard-e; 2.3 përpunojnë tekst, muzikë dhe grafikë;		

	<p>2.4 përdorin organizues grafik dhe storyboard për planifikim;</p> <p>2.5 njihen me programin FLASH;</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>2.13 Përsëritje</p> <p>2.14 Detyrë përmbledhëse</p>		
<p>Programimi në web (16 orë)</p>		<p>3.1 kuptojnë mënyrën se si është ndërtuar Web-i duke u nisur nga shëmbuj të thjeshtë;</p> <p>3.2 kuptojnë një tjetër koncept për editimin e tekstit WYSIWG që përfaqësohet nga programe si Word;</p> <p>3.3 njohin platforma të ndryshme komerciale për të krijuar faqet e tyre Web si DreamWaver, FrontPage, etj.;</p> <p>3.4 mësojnë si integrohet HTML me CSS; mësojnë si të vendosin text, figura, link-e dhe tabela, ne faqen Web duke përdorur HTML/CSS;</p> <p>.....</p> <p>.....</p>	

<p style="text-align: center;">Programimi dhe algoritmika (22 orë)</p>		<p>4.1 familjarizohen me konceptet dhe praktikat kompjuterike dhe analizojnë një algoritëm të thjeshtë për zgjidhjen e disa problemeve;</p> <p>4.2 njohin si të shkruajnë algoritmet;</p> <p>4.3 ndërtojnë bllokskemat e algoritmeve përkatëse;</p> <p>.....</p> <p>4.5 Projekt</p> <p>.....</p>	<p>4.8 njohin gjuhët e programimit dhe konceptet baze të tyre;</p> <p>4.9 konceptojnë programimet kompjuterike në kontekstin e Scratch.</p> <p>4.10 njohin fazat që kalon një program;</p> <p>4.11 krijojnë eksperiencë për gjetjen e burimeve/metodave të ndryshme që mbështesin krijimet e tyre kompjuterike</p> <p>.....</p> <p>.....</p>
<p style="text-align: center;">JAVA (7 orë)</p>			<p>5.1 njohin karakteristikat kryesore të programit JAVA;</p> <p>5.2 njohin dhe testojnë platforma (Integrated Development Environment) të ndryshme për ndërtimin e programeve në Java;</p> <p>5.3 kuptojnë tipet e programeve të JAVA-s :</p>

			Java për aplikacione dhe për Web Detyrë përmbledhëse
--	--	--	--

7.3 Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave, planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

b) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxëni nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës.

c) Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d) Kapitulli

Në këtë rubrikë shënohen kapitujt mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës.

e) Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t’u planifikuar

- 📖 temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. Mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- 📖 orët e projektit që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e TIK-ut si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç. Mësuesi në varësi të kushteve specifike mund të planifikojë projektin në lëndën e TIK-ut me të paktën 3 orë vjetore (nga një për secilën periudhë);
- 📖 orë praktike, përpunim njohurish, përsëritje për detyrën përmbledhëse, etj. për të konsoliduar dhe zbatuar konceptet e fituara në lëndën e TIK-ut;
- 📖 orët e detyrave përmbledhëse për të matur njohuritë e fituara nga nxënësit sipas periudhave përkatëse. Mësuesi planifikon 3 detyra përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. Detyra përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit e saj, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha;
- 📖 orë sipas specifikave të lëndës.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h) Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënës si p.sh., teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Model sugjerues i planifikimit të periudhës së parë në lëndën e TIK-ut, klasa X

Planifikimi i periudhës së parë të lëndës: TIK 10

Periudha e parë: Shtator - Dhjetor

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe

Kompetenca digjitale:

Nxënësi eksploron burime mësimore TIK; merr pjesë në sfidat online; heton analizon dhe zgjidh probleme me burime mësimore TI; krijon animacione origjinale ose dokumentare duke bazuar tek ngjarjet e komunitetit lokalitetit dhe mjediset shkollor; përdor me saktësi komandat e avancuara të programeve standarde për përpunimin e teksteve, tabelave, videove dhe fotografive për prezantim; përdor aftësitë e të menduarit kritik për të planifikuar, hulumtuar e menaxhuar projekte, për të zhvilluar strategji, për të zgjidhur problemet dhe arrin në vendimmarrje në baze të informacionit të fituar duke përdorur mjetet dhe burimet e dhura digjitale;

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:

Nxënësi komunikon në mënyrë efektive; veçon informacionin kryesor nga një burim digjital (internet, Tv, radio etj.) , e komenton atë dhe e shfrytëzon si referencë gjatë hartimit të një përpunimi ose detyre me shkrim; Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit; krijon redaktojnë dhe ndajnë ide dhe informacione, bazohet në konventat e njohura për të shprehurit dhe informacion.

Kompetenca e të menduarit: Nxënësi paraqet në formë të ndryshme (me gojë, të shkruar, grafike, me simbole) argumente për të përforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për problem në fusha të caktuara; përzgjedh dhe klasifikon informacione nga burime të ndryshme në baze të kriterit të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e problemit/detyrës; krijon promovon dhe paraqet një transmetim për një audiencë të gjere; paraqet të paktën një mendim për një detyrë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

Kompetenca e të nxënës: Nxënësi regjistron në formë të shkruar .grafike etj informacionin/ faktet për një temë, veçon me ane të teknikave të ndryshme sipas rëndësisë dhe nevojës për temën /detyrën

shfrytëzon në mënyre efikase fjalorët dhe enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje/projekti në baze klase/shkolle ose jashtë saj; regjistron skedon dhe përdor teknika të tjera për të menaxhuar informacionin/faktet ose formulat për një temë duke i radhitur sipas llojit burimit dhe rëndësisë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Nxënësi përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo dhe publikimeve të ndryshme të shkollës;

Përdor material, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparim në mësim dhe për orientimin në karriere; propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportive, shkencor, teknologjik, artistik, etj

Kompetenca personale: Nxënësi bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klase shkolle dhe jashtë saj; krijon identitete online promovojnë respektin për veten dhe të tjerët në komunikime.

Kompetenca qytetare: Nxënësi punon në një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të mësuarit të gjithë anëtarëve të komunitetit; arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë në shkolle në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulli në shembullin e caktuar; respekton të tjerët dhe janë korrekt në komunikim.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës

Hetimi me TIK: zhvillojnë një pamje web për website-n e tyre në vijim të strategjive të hulumtuara; planifikojnë dhe paraqesin kërkime me bibliografi të shënuar; analizojnë burime informacioni elektronike, kritikojnë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. bashkëpunojnë për të zgjidhur problemin dhe konkurojnë me të tjerët në lojrat interaktive edukative; punojnë me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të integruar të gjithë anëtarët e komunitetit; demonstrojnë njohuri për sistemet komplekse pas zgjidhjes së problemit në to si dhe në mjediset stimuluese ;

Krijimi me TIK: krijojnë, promovojnë dhe paraqesin një transmetim për një audiencë të gjerë; - bashkëpunojnë për të planifikuar dhe prezantuar një produkt digjital të rafinuar teknikisht që integron aplikime të përshtatshme të TIK-ut; - marrin përgjegjësinë për redaktimin e një elementi të një produkti digjital të prodhuar në bashkëpunim; menaxhojnë dhe organizojnë të dhëna duke përdorur mjete të tilla si mail merge; - mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me

konventat e prezantimit të TIK-ut; -përshkruajnë idetë e tyre krijuese dhe hartojnë raportin e tyre në lidhje me pronësinë intelektuale;

Komunikimi me TIK: promovojnë respekt për veten dhe të tjerët në komunikime; -diskutojnë sfidat në lidhje me shfaqjen, parandalimin dhe kontrollin e krimit kibernetik; -kuptojnë shqetësimet e paraqitura nga rrjete të veçanta online; -planifikojnë një projekt këmbimi online, e zbatojnë atë dhe tërheqin pjesëmarrësit në të; zgjedhin dhe rekomandojnë zgjidhje software bashkëpunuese të përshtatshme për qëllime të veçanta; -bëjnë rekomandime për përdorimin etik të pajisjeve të reja;

Menaxhimi dhe Operimi me TIK: -përshkruajnë rreziqet specifike të sistemit të tilla si: mosfunksionimi i celularit dhe se si ti heqin ato ; -krahasojnë sistemet e përbashkëta të lidhjes të tilla si dial-up, ADSL, Wireless Broadband; -analizojnë dhe krahasojnë përgjegjësinë e TIK duke përdorur politikat e organizatave të ndryshme; bëjnë dallimin ndërmjet funksioneve të sistemeve operative software dhe aplikacioneve software; -përshkruajnë tiparet kryesore të rrjeteve të një sistemi operativ të tilla si kontrollin e aksesit, shërbimet e dosjeve dhe shkëmbimi;

Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un: Identifikojnë dhe përshkruajnë dilemat etike; -përdorin një sërë strategjish për sigurimin dhe mbrojtjen e informacionit; -në mënyrë të pavarur aplikojnë strategjitë e duhura për të mbrojtur të drejtat, identitetin, jetën private dhe sigurinë emocionale të tjerëve gjatë përdorimit të TIK-ut; -vlerësojnë ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri.

Nr	Tema mësimore	Tema tika	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	Ruajtja e informacionit dhe protokollet backup	Bota e kompjuterit	Shpesh, gjatë punës në kompjuter na ka ndodhur që informacione të ndryshme të kenë humbur, pasi kompjuteri është prishur në çast. Çfarë duhet bërë për të ruajtur këto informacione?	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë. drejtim i imagjinatës, bisedë gjithëpërfshirëse; bashkërendim idesh.	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve	Teksti i nxënësit Kompjuter, projektor internet..etj
2	Problemet që shfaqen gjatë punës në	Bota e kompjute	Gjatë punës në kompjuter na ndodh të hasim probleme,	Punë krijuese individuale	Vlerësim në formë motivimi,	Teksti i nxënësit Kompjuter,

	kompjuter dhe zgjidhja e tyre		si: mbyllja vetë e kompjuterit, ngadalësimi i tij, “ngrirja” e komandave etj. Si duhet të veprojmë?		evidentimi dhe kultivimi i prirjeve	projektor internet..etj
3	Ergonomia në mjediset TIK	Bota e kompjuterit	Orët e gjata para kompjuterit shkaktojnë probleme kritike për shëndetin tonë, duke na sjellë: lodhje muskujsh, dhimbje të shpinës, stres, ulje të rendimentit në punë etj.	Punë individuale	Vlerësim në formë edukimi, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre	Teksti i nxënësit Kompjuter, projektor internet..etj
4	Rrjetet kompjuterike dhe topologjia e tyre	Bota e kompjuterit	Rrjeti i parë dhe më i madh i komunikimit për sistemet telefonike është ai me kablo. Në këtë mësim do të njohim si bëhet e mundur kjo lidhje nëpërmjet kompjuterit.	Punë praktike individuale	Vlerësim individual me notë. Vlerësim i argumentimit dhe përgjigjeve mbi temën	Teksti i nxënësit Kompjuter, projektor internet..etj
5	<i>Tema mësimore</i>	Bota e kompjuterit
6	<i>Tema mësimore</i>	Bota e kompjuterit
...	Bota e të dhënave digjitale	Përpunimi digjital i të dhënave	Sa të domosdoshme e shihni përdorimin e celularit në jetën e përditshme? Sa ju shërben kompjuteri gjatë procesit të të nxënësit?	Punë laboratorit	Vlerësimi në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve	Teksti i nxënësit Kompjuteri dhe interneti

...	Llojet e të dhënave digjitale dhe menaxhimi i tyre	Përpunimi digjital i të dhënave	Çfarë ju sjellin ndërmend simbolet e mëposhtme? Diskutoni ku dhe për çfarë përdorën?	Punë individuale, hulumtim.	Vlerësimi fokusohet në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të	Kompjuteri dhe interneti
...	Përpunimi i të dhënave digjitale (tekst, audio, imazhe)	Përpunimi digjital i të dhënave	Përmendni dhe diskutoni mbi programet që njihni për përpunimin e të dhënave digjitale	Punë në grup	Vlerësimi fokusohet në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve	Teksti i nxënësit Kompjuter, projektor internet..etj
...	<i>Tema mësimore</i>	Përpunimi digjital i të dhënave
...	<i>Tema mësimore</i>	Përpunimi digjital i të dhënave
...	<i>Tema mësimore</i>	Përpunimi digjital i të dhënave
27	Përsëritje	Përpunimi digjital i të dhënave	Diskutim i njohurive të marra përgjatë tematikës 1, 2	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë. drejtim i imagjinatës, bisedë gjithëpërfshirëse; bashkërendim idesh.	Vlerësim me listë treguesish	Teksti i nxënësit Kompjuter, projektor internet..etj
28	Detyrë përmbledhëse	Përpunimi digjital i të dhënave	Punë individuale me kompjuter	Zhvillimi i detyrës përmbledhëse	Vlerësim i arritjeve individuale (NDP)	Detyrat e nxënësve;

7.1 Planifikimi ditor

Për përgatitjen e planit ditor mësuesi përcakton së pari rezultatet e të nxënësve të asaj ore mësimi, përgatit veprimtaritë mësimore duke bërë kujdes të veçantë për përzgjedhjen e metodave dhe strategjive ndërvepruese, përzgjedh burimet e të nxënësve, përcakton teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, planifikon punën me klasën, me grupet, me nxënës të veçantë, përcakton lidhjen me lëndët e tjera etj. Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
Mësimi përqendrohet pothuajse te përmbajtja.	Mësimi përqendrohet mbi proceset dhe mbi veprimtaritë.
Mësimi pritet të ketë të njëjtin organizim të orës së mësimit gjithmonë.	Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.
Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	Roli i mësuesit është organizator duke mbizotëruar dhe duke e vënë theksin te bashkëveprimi i nxënësve.

Shembuj të foljeve për rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave lëndore

Folje të përgjithshme sipas taksonomisë së Blumit	Folje më specifike për ndërtimin e kompetencave
<i>kujton</i>	pranon; sjell ndërmend; liston; identifikon; korrigjon etj.
<i>kupton</i>	interpretton; ilustron; klasifikon; përmbledh; konkludon; krahason; shpjegon; qartëson; perifrazon; paraqet; përkthen; ilustron; kategorizon; përfshin; abstragon, parashikon; regjistron; ballafaqon; lidh etj.

<i>zbaton</i>	ekzekuton; realizon, identifikon; përgjithëson; kryen; përdor; etj
<i>analizon</i>	diferencon; organizon; i vë përballë; ndërton modele shkak – pasojë; dallon; përqendron; përzgjedh; integron, skicon; strukturon etj.
<i>vlerëson</i>	koordinon; zbulon; monitoron; teston; gjykon; kontrollon; kritikon;
<i>krijon</i>	gjeneron; planifikon; prodhon; hamendëson; projekton; ndërton; sintetizon.

Model i planifikimit ditor

Fusha: TEKNOLOGJI DHE TIK	Lënda: TIK	Shkalla: 5	Klasa: X
Tematika: Programimi në Web		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: HTML dhe CSS		Stilizimi i elementeve HTML ndërmjet përdorimit të gjuhës CSS në tri mënyra të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas temës mësimore:			
<i>Nxënësi:</i>			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ njeh rolin e përdorimit të gjuhës CSS në faqet e internetit (website) ▪ identifikon mënyrat e inkorporimit të elementeve CSS në dokumentet HTML ▪ aplikon njohuritë e marra në stilizimin praktik të elementeve HTML 			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Mateamatikë, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi; ...etj.		Burimet: Libri i nxënësit; videoprojektor; laboratori i TIK-ut; laptop; tableta, program Notepad++	Fjalët kyçe: HyperText Markup Language (HTML), Cascading Style Sheets (CSS), sintaksë, stilizim, skedarë, paragrafë, imazh, link.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësim:			
<i>Parashikimi (Diskutim për njohuritë paraprake)</i>			

Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të shkurtra që kanë lidhje me temën e mësimit të ri:

- Si mendoni ju se si realizohet stilizimi i faqeve të internetit?
- Cilat janë elementet grafike që ju tërheqin më shumë vëmendjen kur jeni duke naviguar në një faqe interneti?
- Sa të familjarizuar jeni ju me gjuhën CSS?
- Cili mendoni se është roli i përdorimit të kësaj gjuhe në dokumentat HTML?


Nxënësit japin përgjigjet e tyre lidhur me pyetjet e mësipërme. Ata komentojnë përgjigjet e shokëve/shoqeve dhe shtojnë ide të reja. Mendimet më të sakta mësuesi mund ti shkruajë në flipçart ose në dërrasën e zezë.

Pasi ka ftuar nxënësit në diskutim dhe ka marrë një feedback lidhur me njohuritë aktuale që nxënësit zotërojnë rreth gjuhës CSS, mësuesi shkruan në tabelë ose në flipchart **HTML + CSS** dhe nxit nxënësit të japin përgjigje lidhur me funksionin e përdorimit të këtyre gjuhëve duke marrë në konsideratë të përbashkëtat dhe dallimet që mund të kenë këto dy gjuhë.

HTML

CSS

Në përfundim të diskutimit paraprak me nxënësit, mësuesi paraqet në videoprojektor imazhin e mëposhtëm , i cili paralelizon përdorimin e gjuhës HTML dhe CSS me situatë nga jeta e përditshme, për të kuptuar më qartë arsyen e përdorimit të kodit CSS në dokumentat HTML.



Ndërtimi i njohurive:

Mësuesi shpjegon në terma teorik funksionimin e përdorimit të gjuhës CSS, së bashku me mënyrat e inkooporimit dhe përfshirjes të elementeve CSS në dokumentet HTML.

Mënyrat e përfshirjes së kodeve CSS në një file **.html**

- a) Inline (në një rresh) duke përdorur atributin style brenda elementi HTML
- b) Internal (e brendshme) duke përdorur tagun <style> </style> në seksionin e head-it
- c) External (e jashtme) duke përdorur një file CSS të jashtëm

Mësuesi i fton nxënësit të hapin programin Notepad++ ose një editor online dhe të krijojnë strukturën e një dokumenti HTML. Për nxënësit, të cilët paraqesin vështirësi në krijimin e strukturës së dokumentit HTML, mësuesi i inkurajonë këta nxënës të ndjekin paralelisht punën që ai/ajo po shfaq në video-projektor.

Pasi nxënësit kanë krijuar strukturën e dokumentit, mësuesi i thotë nxënësve që në dokumentin e ruajtur (save) me prapashtesën **.html** të shtojnë disa elemente të njohura për ta siç mund të jenë: paragrafët, headings, imazhet, linqet etj...

Nxënësit ndahen në grupe dhe përcaktohen detyrat për secilin grup:

Grupi I: Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin inline

Grupi II: Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin internal

Grupi III: Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin external, me ndihmën e një skedari të jashtëm të pavarur të ruajtur me prapashtesën **.css**

Mësuesi përcakton formatin e stilizimit për secilin nga elementet HTML

<body> </body> sfondi i background-it duhet të jetë ngjyrë kafe

<p> </p> teksti i shkruajtur brenda paragrafit duhet të jetë i llojit "Helvetica" dhe me ngjyrë të bardhë.

<h1> </h1> teksti i shënuar brenda headings duhet të jetë i nënvizuar dhe me ngjyrë të verdhë.

**** imazhet duhet të përmbajnë një kornizim 5 px me ngjyrë të zezë.

Ndërkohë që nxënësit punojnë në çifte për realizimin e kësaj detyre, mësuesi kalon nëpër kompjuterat e nxënësve për të parë ecurinë e punës, për të kontrolluar nivelin e përvetësimit të njohurive të marra, si dhe për të dhënë ndonjë ndihmë lidhur me pyetjet, paqartësitë apo vështirësitë që nxënësit hasin.

Pasi nxënësit kanë mbaruar me shkrimin e kodit, mësuesi fton para klasës një çift përfaqësuesish nga secili grup për të ekzekutuar kodin në kompjuterin e lidhur me video projektoren.

▪ *Stilizimi inline*

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<title>Page Title</title>

</head>
<body style="background:brown;">
<h1 style="color:yellow; text-decoration:underline;">Historia e Skënderbeut</h1>
<p style="color:white; font-family: Helvetica;">Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.</p>

</body>
</html>
```



▪ *Stilizimi external*

```

body {
  background-color: brown;}
h1 {
  color: yellow;
  text-decoration: underline;}
p{
color:white; font-family: Helvetica;}
img
{border:5px solid black;
}

```

File name:

Save as type:



Mësuesi fton nxënësit të japin komente lidhur me mënyrën më efektive të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML, si dhe të japin një vlerësim lidhur me punën e realizuar nga grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Për vlerësimin e nxënësve do të përdoren: përgjigjet me gojë, vëzhgime të drejtëpërdrejta gjatë punës në çift dhe individuale.

Nxënësi vlerësohet për:

- Identifikimin e tri mënyrave të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML
- Stilizimin e elementeve HTML duke përdorur gjuhën CSS
- Aplikimin e njohurive të marra duke krijuar faqe të thjeshta html me elementë të ndryshëm stilizimi.
- Përdorimin e fjalorit informatikë
- Bashkëpunimin përgjatë punës në grup

Vlerësimi bazuar në nivelet e arritjeve:

Niveli 2: Identifikon mënyrat e përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML

Niveli 3: Përdor disa prej mënyrave të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML për të stilizuar elementë të thjeshtë që mund të përmbajë një faqe interneti.

Niveli 4: Vlerëson rëndësinë e përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML duke argumentuar rreth përzgjedhjes së mënyrave më efektive.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve i'u kërkohet të krijojnë një faqe web-i për një biznes lokal, ku të vendosen të gjithë elementet (taget) HTML të mësuara deri më tani dhe për elementë të ndryshëm të përdoren tri metodat e përfshirjes së kodit CSS. Detyra do të sillet e printuar dhe skedarët .html dhe .css të jenë të ruajtur në një USB për të parë ekzekutimin në klasë.

VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E TIK-UT

Qëllimi i vlerësimit: Qëllimi kryesor i vlerësimit është *përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve* nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit *mbledhjen të dhënave dhe gjykohet për vlerën* e arritjes së rezultateve të të nxënësve bazuar në nivelet e arritjes.

Vlerësimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies - nxënësve. Vlerësimi përdoret për:

- ☒ të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve;
- ☒ të matur arritjet e nxënësve;
- ☒ të gjykuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënies -nxënësve;
- ☒ të raportuar arritjet;
- ☒ t'i dhënë sugjerime nxënësve për përpjekjet e tyre.

Vlerësimi në matematikë mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënësve të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësve dhe mund të integrohet në të nxënësve normal të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve kryhet nëpërmjet:

- ☒ vlerësimit të vazhduar;
- ☒ vlerësimit me detyrë përmbledhëse;
- ☒ vlerësimin me projekt kurrikular.

8.1 Vlerësimi i vazhduar (për të nxënësve)

- *Vlerësimi i vazhduar për të nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përpjekjet e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënësve, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.*

- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe në debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- Mësuesi vlerëson nxënësin me notë në regjistër, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe. Për këtë qëllim, mësuesi përdor fletoren e tij personale të regjistrimit të përgjigjeve të nxënësit, për të argumentuar në çdo kohë, objektivitetin e vlerësimit të tij me notë në regjistër.
- Fletorja personale e mësuesit nuk është objekt monitorimi.
- Mësuesi shënon në regjistër të paktën 2 (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë për lëndët që zhvillohen me 1-2 orë në javë dhe 3 (tri) vlerësime me notë për lëndët që zhvillohen me 3 ose më shumë orë në javë.
- Mësuesi nxjerr notën e vlerësimit të vazhduar për çdo periudhë duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër dhe në shënimet që ka mbajtur në fletoren e tij personale. Mësuesi merr në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënit në programin lëndor.
- Mësuesi ka përgjegjësi për të informuar prindërit dhe nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres.

8.2 Vlerësimi i të nxënit (detyrë përmbledhëse)

Vlerësimi i të nxënit quhet shpesh vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësime të mësuara ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një njësie apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim *formal* dhe kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e vendos mësuesi) kryhet *vlerësimi me detyrë përmbledhëse*, i cili ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse. Detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë.

Si dhe kur realizohet detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **vlerësimi me detyrë përmbledhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi, kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është **i lirë** dhe ka fleksibilitet ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë (jo domosdoshmërisht bëhet në fund të periudhës).
- Detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Detyra përmbledhëse **jo domosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë. (*Shih shembullin te planifikimi i lëndës për një periudhë*).
- Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor detyrat përmbledhëse.
- Vlerësimi i detyrës përmbledhëse pasqyrohet në regjistër, në kolonën përkatëse.

Vlerësimi me detyrë përmbledhëse është një vlerësim që për lëndën e TIK-ut duhet të zhvillohet më shumë nëpërmjet një aktiviteve praktike. Detyra përmbledhëse, ka për qëllim të mat nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënit. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të vlerësohen nëpërmjet një larmi mënyrash vlerësimi.

Analiza e rezultateve të detyrës përmbledhëse

Analiza e rezultateve të detyrës përmbledhëse është një detyrë e vazhdueshme e mësuesit dhe mjaft e rëndësishme në vetëvlerësimin e performancës së tij në periudha të ndryshme, në lidhje me rezultatet e nxënësve. Kjo lloj analize bën të mundur që mësuesi të kuptojë shkaqet e rezultatit të nxënësve (në këtë rast marrim si shembull, rezultate të pakënaqshme) në detyrën përmbledhëse. Shkaqet mund të jenë të ndryshme dhe mund të kenë lidhje; si me njohuritë dhe aftësitë e tyre të mëparshme; me humbjen e interesit të nxënësve ndaj lëndës së TIK-ut (kjo si rezultat i interesave që lidhen me moshën ose me mungesën e motivimit); përzgjedhjen e veprimtarive digjitale jo në përshatje me interesat e moshës apo aftësitë personale të secilit; apo përdorimi jo në mënyrë efektive i metodave të mësimdhënies; etj..

Një analizë e tillë do ta çojë mësuesin drejt reflektimit me kujdes ndaj çdo shkakut të mundshëm, si në mënyrë personale ndaj çdo nxënësi, ashtu edhe në rang klase. Ky reflektim do të sillte edhe zgjidhjet e duhura brenda çdo problemi specifik. Për shembull, nëse rezultatet e pakënaqshme kanë lidhje me humbjen e interesit të nxënësve ndaj TIK-ut dhe kjo vjen si rezultat i moshës së

tyre, nxënësit bëhen kritikues dhe të pakënaqur ndaj cilësisë së punimeve të tyre. Në këtë rast puna dhe orientimi i duhur nga ana e mësuesit është mjaft i rëndësishëm.

Shembull: Detyrë përmbledhëse TIK, klasa X

Krijimi i një dokumenti në HTML

Dokumenti HTML do përmbajë:

- *Titullin me emrin tuaj.*
- *Një paragraf i cili duhet të përmbajë minimalisht 150 fjalë.*
- *Një tabelë me 4 rreshta dhe 3 shtylla, e cila duhet të jetë e populluar me rezultatet e detyrës përmbledhëse për të tri periudhat.*
- *Një listë të renditur ose të parenditur elementësh (deri 3 elementë).*
- *Një link i cili bën të mundur adresimin në faqen www.ascap.edu.al*
- *Një formular ku të përdoren minimalisht 5 lloje të ndryshme të input type*
- *Shpjegoni hapat që ndoqet për realizimin e detyrës(shkrimin e kodit dhe ekzekutimin e dokumentit HTML duke sqaruar etiketat e përdorura në kod)*

Me realizimin e kësaj detyre përmbledhëse, do të kontrollohen këto **njohuri**:

- Gjuha HTML dhe sintaksa e saj
- Vendosja e tekstit, paragrafëve, imazheve
- Vendosja e hyperlinks
- Tabelat në HTML
- Ndërtimi i formularëve në HTML

Me anë të realizimit të kësaj detyre, nxënësi duhet:

- ☒ Të kuptojë mënyrën se si kodohen faqet web ;
- ☒ Të kuptojnë strukturën organizative të komponentëve të faqeve të internetit;
- ☒ Të familjarizohen me sintaksën e gjuhës së markimit HTML.
- ☒ Të shtojnë elemente të ndryshëm në dokumentet e krijuara (tekst, imazhe, lista, hyperlinks, tabela etj...)
- ☒ Të shpjegojnë tag-et dhe pjesët e kodit duke parashikuar rezultatin në dalje.

Specifikat e ndërtimit të detyrës përmbledhëse të periudhës parë Klasa 10 :

Kjo detyrë është ndërtuar mbi bazën e 20 orëve mësimore.

Kërkesat janë ndërtuar në bazë të njohurive dhe llojeve të studiuara në këto tema të përmendura edhe më sipër.

Kështu që, në tabelën më poshtë janë specifikuar peshat e secilës tematikë:

Fushat	Orët	Përqindja që zë	Pikët
Programimi në Web	20 orë	100 %	25 pikë
Totali	20 orë	100%	25 pikë

Kriteret e vlerësimit ²sipas elementëve të mësuar:

Nr	Njohuri të mësuar	Shumë mirë 3	Mirë 2	Mjaftueshëm 1	Dobët 0
1	Saktësia e shkrimit të kodit				
2	Realizimi i kërkesave				
3	Shtimi i simboleve, imazheve, ovjekteve..etj				
4	Paraqitja estetike				
5	Pozicionimi i elementeve				
6	Estetika e prezantimit				
7	Demonstrimi me individualitet				

Pikë	0 - 5	6 - 8	9-11	13 - 15	17-19	20 -22	23 - 25
Nota	4	5	6	7	8	9	10
Niveli	N_1	N_2		N_3		N_4	

8.3 Projekti kurrikular

Projekti kurrikular është pjesë e vlerësimit të nxënësit.

Gjatë vlerësimit me projekt kurrikular:

- Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë gjithë vitit shkollor.
- Projekti kurrikular mund të jetë lëndor ose ndërlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxëni ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxëni.

² Mësuesi në varësi të specifikave dhe tipologjisë së detyrës përmbledhëse mund të përcaktojë vetë kriteret e vlerësimit të njohurive të nxënësve.

- Drejtoria e shkollës menaxhon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
- Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
- Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.

Projekti kurrikular duhet të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij. Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vrojtimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni statistikor etj.

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- ☒ Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- ☒ Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- ☒ Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- ☒ Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.

- ✎ Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- ✎ Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij, mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- *Tema e projektit* (Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore* (Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- *Klasa/t pjesëmarrëse:* (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- *Rezultatet e të nxënit* – (Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:* (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- *Partnerët* (Nëse ka, p.sh., nëse projekti në lëndën e gjeografisë ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për ndotjen mjedisore në zonën ku banojnë, një specialist i mjedisit mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt).
- *Veprimtaritë kryesore:* (përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit).
- *Burimet kryesore të informacionit* (Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e gjeografisë një burim i çmuar informacioni, përveç internetit, hartave dhe teksteve të ndryshme si enciklopeditë, revistat, etj., janë vëzhgimet në natyrë).
- *Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:* (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. Psh nëse projekti planifikohet në 6 orë atëherë duhet vendosur tematika për të gjashta orët)
- *Përshkrimi i produktit të projektit* (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- *Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi* (Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në

lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënës.

- Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënësin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme).

Shembull i vlerësimit të projektit kurrikular. Çdo mësues është i lirë të vendosë vetë kriteret e vlerësimit të projektit sipas tematikës që ka përzgjedhur për të realizuar me nxënësit.

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PROJEKTIT NGA MËSUESI				
PROJEKT KURRIKULAR HULUMTUES				
<i>Projekti përmban gjithsej 40 pikë</i>				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët 0-10 pikë	Niveli 2 – Mjaftueshëm 11 - 21 pikë	Niveli 3 – Mirë 22- 32 pikë	Niveli 4 – Shumë mirë 33 -40 pikë
15 pikë (Faza e parë) Demonstrimi i aftësive hulumtuuese	0-4 pikë <i>Nxënësit:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ rrallëherë fokusohen te detyra e tyre. ▪ mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. ▪ përdorin një burim për të gjetur informacione. 	5-8 pikë <i>Nxënësit:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre. ▪ mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. ▪ përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione. 	9-12 pikë <i>Nxënësit:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ janë të fokusuar te detyra e tyre shumicën e kohës. ▪ mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. ▪ përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione. 	13-15 pikë <i>Nxënësit:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ janë të fokusuar te detyra e tyre. vectorientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. ▪ mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe krijojnë komente intuitive për të zgjidhur probleme. ▪ përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
15 pikë	0-4 pikë	5-8 pikë	9 -12 pikë	13-15 pikë

<p>(Faza e dytë)</p> <p>Realizimi i kërkimit të gjetur</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit rrallëherë përdorin teknika të përshtatshme. ▪ informacioni i grumbulluar shpeshherë është jo i saktë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. ▪ shtjellimi i kërkimit është me gabime. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit zakonisht përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. ▪ shtjellimi i kërkimit përmban pak gabime. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. ▪ shtjellimi i kërkimit është i saktë dhe i qartë.
<p>10 pikë (Faza e tretë)</p> <p>Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit</p>	<p>0-2 pikë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në prezantimin e tyre materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin. ▪ Prezantohen shumë pak rezultate të projektit. 	<p>3-5 pikë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre, jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. ▪ Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit. 	<p>6-8 pikë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. ▪ Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit. 	<p>9-10pikë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. ▪ Rezultatet e projektit prezantohen qartë.

Shembull i vetëvlerësimit ose e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Edhe ky shembull është një model që shërben për të orientuar çdo mësues dhe nxënës rreth vlerësimit. Edhe në këtë rast çdo mësues është i lirë të vendosë kriteret sipas tematikave që përzgjedh të zhvillojë.

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PROJEKTIT					
PROJEKT KURRIKULAR HULUMTUES					
<i>Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjithë vitin)</i>					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	ShM	M	Mj	D

15 pikë (Faza e parë) Demonstrimi i aftësive hulumtuese	Demonstrim i aftësive hulumtuese				
	Bashkëpunimi në grup				
	Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve				
	Fokusimi te detyra e dhënë				
	Mbledhja e informacioneve të përshtatshme për detyrën				
15 pikë (Faza e dytë) Realizimi i kërkimit të gjetur	Përdorimi gjatë projektit i aftësive kërkimore të përshtatshme dhe efektive.				
	Informacioni përputhet me njohuritë shkencore të marra në lëndën e TIK-ut.				
	Përdorimi i informacionit të gjetur dhe				
10 pikë (Faza e tretë) Prezantimi dhe komunikimi në mënyrë efektive i rezultateve të projektit	Organizimi i materialit që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.				
	Rezultatet e projektit prezantohen qartë.				
	Kontribuon pozitivisht në progresin e grupit				

Shembull projekti kurrikular me shtrirje vjetore, për lëndën e TIK për klasën XI.

- 1. Tema e projektit** “Studimi i një Baze të Dhënash(BDH)”
- 2. Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:** Projekti do të zgjasë gjatë tri periudhave të realizuara në 3 orë mësimore në lëndën e TIK-ut, të planifikuara 1 orë për çdo periudhë **Klasa/t pjesëmarrëse:** Klasa e XI-a,b,c,d,
- 3. Rezultatet e të nxënës** – Në përfundim të projektit nxënësi:
 - demonstroi njohuritë e marra për funksionimin e bazave të të dhënave;
 - prezantoi të dhënat në përshtatje me temën, redaktonte dhe ndan ide dhe informacione.
 - prezantoi studimin e bazave të të dhënave para një audiencë të gjerë .
 - përzgjedh saktë të dhënat për studimin e bazave të të dhënave nga burime të ndryshme në bazë të temës së projektit.
 - përdori me saktësi komandat e avancuara të programeve standarde për përpunimin e të dhënave në një BDH.

- propozon alternativa të ndryshme sesi qytetarët mund të kontribuojnë në këtë projekt studimi BDH.
- zgjedh dhe përdor mjetin TIK të përshtatshëm për të ndarë dhe për të shkëmbyer informacione dhe bashkëpunon me të tjerët në mënyrë të sigurt;
- paraqet dhe komunikon idetë e hartuara duke përdorur standardet e modelimit dhe të dizenjimit duke përfshirë teknologjitë digjitale;
- përdor terminologjinë e duhur të TIK-ut për të përshkruar, analizuar, dhe vlerësuar rëndësinë e internetit dhe shërbimeve elektronike në jetën e përditshme.
- prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
- bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.

4. Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- ✗ qëllimi i studimit;
- ✗ Krijimi i një BDH
- ✗ Përdorimi saktë i komandave për ndërtimin dhe plotësimin e tabelave me rekorde.
- ✗ Kërkimi i informacionit.
- ✗ Krijimi i query ,formave raporteve për një tabelë.
- ✗ Krijimi i query-ve për 2 tabelat të lidhura me një fushë të njëjtë.
- ✗ Ruajtja e tabelave, query-ve, formave dhe raporteve në programin Access.
- ✗ interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

5. Partnerët që do marrin pjesë në projekt – prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

6. Veprimtaritë kryesore:

- 📖 Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit.
- 📖 Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- 📖 Zgjedhja nga nxënësit e detyrës praktike për secilin grup.
- 📖 Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
- 📖 Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
- 📖 Kërkime njohurish të nevojshme në literaturën e rekomanduar, apo në internet në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre praktike dhe studimore.
- 📖 Hulumtimi lidhur me krijimin dhe funksionimin e bazave të të dhënave .

- 📖 Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
- 📖 Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale.
- 📖 Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit..

7. *Burimet kryesore të informacionit:*

- ☞ Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve
- ☞ Materiale të marra nga interneti
- ☞ Teksti mësimor i TIK-ut
- ☞ Tekste të tjera lëndore që lidhen me situatën konkrete.

Baza materiale:

- Interent
- Videoprojektor
- Libri TIK-ut
- Literaturë plotësuese
- Lapustila

8. *Tematika e orëve të planifikuara:*

- 📖 *Ora 1.* Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- 📖 *Ora 2.* Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i punëve të ndara. Përpunimi i materialit të përgatitur, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme. Nxënësit paraqesin punën e bërë gjatë kësaj faze të projektit. diskutohet me grupet e punës mbi kërkimet e kryera, informacionin e grumbulluar, a është në përputhje me temën, si është bërë përzgjedhja dhe përpunimi i tij nga secili grup. -diskutimi mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës i ndihmon ata të përfitojnë ide nga sugjerimet e njëri- tjetrit; çdo nxënës dorëzon produktin e punës së tij sipas detyrës së përcaktuar brenda grupit.
- 📖 *Ora 3:* Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

9. *Përshkrimi i produktit të projektit*

Projekti do të përqendrohet në mbledhjen e informacioneve nga burime të ndryshme, dhe aplikimin e tyre në një detyrë praktike lidhur me krijimin e një baze të dhëne relacionale

ndërmjet programit Microsoft Access. Nxënësit do të përcaktojnë saktë kriteret për ndërtimin e queryve, krijimit të formave dhe raporteteve, si dhe të zbatojnë me përpikmëri këshillat për një studim të saktë të BDH.

Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
- Rezultatet e të nxënit
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit. Një shembull tablele e planit të veprimtarive paraqitet më poshtë:

Faza e parë		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtari i grupit
Psh. Hulumtimi i të dhënave lidhur me krijimin e databasave dhe përpunimin digjital të të dhënave në programin Microsoft Access.	15 tetor 201..	Anëtari
.....		
Psh. Përzgjedhja e tipologjisë dhe studimi i mjedisit për krijimin dhe dizenjimin e bazës së të dhënave. (bibliotekë, shkollë, supermarket, spital etj...)	20 tetor 201...	Anëtari
.....		
Faza e dytë		
Psh. Grumbullimi i materialeve nga burime të tjera dhe aplikimi i njohurive në përgatitjen e draftit paraprak të databasës së krijuar.	10 Janar 202..	Anëtari
.....		
Psh. Përpunimi i materialit dhe shtimi i funksionaliteteve të reja në databasë	2 shkurt 202...	Anëtari

.....		
Faza e tretë		
Psh. Përmirësimi i mjedisit të databasës relacionale dhe testimi i queryve.	9 Mars 202..	Anëtari
.....		
Psh. Punimi i materialit në kompjuter	3 Prill 202...	Anëtari
.....		
Psh. Përgatitja e projektit për prezantim	15 Prill 202..	Anëtari ...
.....		

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. (*Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik power point, nëse është produkt, prezantohet produkti etj.*)
- Konkluzione të projektit.

10. Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas tabelës 3 për vlerësimin e projekteve kurrikularë të përcaktuar sipas niveleve të mësipërme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situatën të ndryshme dhe arsyetimet intuitive.
- Përdorimi i saktë i koncepteve të TIK-ut.
- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme kërkimore.
- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohet dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

8.4 Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve realizohet nëpërmjet:

- a) Vlerësimi periodik,

b) Vlerësimin përfundimtar.

8.4.1 Vlerësimi periodik

1. Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimin të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2 (dy) nota:
 - a) Notën e vlerësimin të vazhduar,
 - b) Notën e vlerësimin me *detyrë përmbledhëse*.
2. Këto dy vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse.

8.4.2 Vlerësimi përfundimtar

1. Vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
2. Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:
 - a) Notën vjetore të vlerësimin të vazhduar për tri periudha.
 - b) Notën vjetore të vlerësimin me test/*detyrë përmbledhëse* për tri periudha.
 - c) Nota e vlerësimin të projektit.
3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:

	<i>Pesha në përqindje klasat VI-IX</i>
<i>Vlerësimi i vazhduar</i>	40%
<i>Vlerësimi me detyrë përmbledhëse</i>	40%
<i>Vlerësimi i projektit kurrikular</i>	20%

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:

- a) Nota vjetore e vlerësimin të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimin të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- b) Nota vjetore e vlerësimin me detyrë përmbledhëse (Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimin me detyrë përmbledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- c) Nota e vlerësimin të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar.
- d) Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).
- e) Formulatat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:

- Nota përfundimtare në klasat VI-IX = $(NV_v \times 0.4) + (NTp/Dp \times 0.4) + (NV_p \times 0.2)$
- f) Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë <i>Shtator – Dhjetor</i>		Periudha e dytë <i>Janar - Mars</i>		Periudha e tretë <i>Prill - Qershor</i>		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _p	8
6	6	8	7	8	7	8	7	9	

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Nota përfundimtare 8

ose

$$(7 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.4$$

Nota përfundimtare 7

8.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënësve. Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtasë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë. Këto modifikime mund të përfshijnë:

- Ndryshimin/përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh. një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit.
- Modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh. duke thjeshtuar gjuhën e përdorur, ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi.
- Përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh. duke i dhënë kohë shtesë nxënësit, me pauza të ndërmjetme, duke përdorur një lexues ose teknologji specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen shpesh herë me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRA TË NDRYSHME NË LËNDËN E TIK-UT.

9.1 Kriteret për kryerjen e detyrave

Mësuesi duhet të përcaktojë kriteret vlerësimi për çdo detyrë dhe të sigurojë udhëzime të qarta për nxënësit se si do të jetë detyra e përfunduar dhe si do të zbatohen kriteret. Kur vendosni një detyrë sigurohuni që:

- kërkesat e detyrës janë bërë sa më qartë të jetë e mundur për nxënësin;
- kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes t'i ofrohen çdo nxënësi në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë;
- çdo burim ose material i përdorur të jetë i qartë dhe i përshtatshëm për detyrën;
- arritjet e nxënësit maten për më shumë se një rezultat të nxëni;
- udhëzimet të jenë të qarta dhe koncize;
- niveli i gjuhës të jetë i përshtatshëm për vlerësimin;
- detyra nuk përmban gjini, kulturë ose ndonjë paragjykim tjetër;
- koha e lejuar është e mjaftueshme për kryerjen e detyrës.

9.2. Reflektimi i mësuesit

Kur vlerësoni detyrën, mos harroni se reflektimet tuaja do të ndihmojnë nxënësin të kuptojë pse ai / ajo mori atë rezultat dhe si mund të bëhet më mirë herën tjetër.

Reflektimi duhet të jetë:

- konstruktiv në mënyrë që nxënësi të ndihet i inkurajuar dhe i motivuar për t'u përmirësuar;
- në kohë, në mënyrë që nxënësi ta përdorë atë për të mësuar në vazhdim;
- i menjëhershëm në mënyrë që nxënësi të mund të mbajë mend atë që bëri dhe të reflektojë në kohë;
- i fokusuar në arritje dhe përpjekje, jo te personi - puna duhet të vlerësohet, jo nxënësi;
- specifike për rezultatet e të nxënit në mënyrë që vlerësimi të jetë i qartë lidhur me të mësuarin.

Përgjigjet tuaja mund të jenë:

- informale ose indirekte - të tilla si reagimet verbale në klasë (me tërë klasën), ose në mënyrë individuale me vetë nxënësin.
- formale ose të drejtpërdrejta - të tilla si listat e kontrollit ose komentet për nxënësin në mënyrë individuale në formë të shkruar ose verbale;
- formative – të dhëna gjatë mësimit me qëllim ndihmës për nxënësin që të di se si të përmirësohet;
- përmbledhëse – të dhëna në fund të periudhës (ose të kapitullit) me qëllim informimin e nxënësve për çfarë kanë arritur.

9.3 Kriteret e vlerësimit të detyrave

Kriteret e vlerësimit mësuesi i vendos në varësi të llojit të detyrës. Më poshtë është paraqitur *një shembull* për kriteret e vlerësimit të një detyre.

Kriteret i vlerësimit	Kriteret për vlerësimin e një detyre me 10 pikë			
	Niveli 1 Dobët 0-2 pikë	Niveli 2 Mjaftueshëm 3-5 pikë	Niveli 3 Mirë 6-8 pikë	Niveli 4 Shumë mirë 9 -10 pikë
Fokusi te detyra dhe burimet e përdorura	Nxënësit rrallëherë fokusohen te detyra e tyre. Informacioni është i gatshëm. Përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre. Mbledhin disa informacione nga dy burime të ndryshme.	Nxënësit janë të fokusuar te detyra e tyre Mbledhin informacione nga të paktën dy burime të ndryshme.	Nxënësit janë të fokusuar te detyra e tyre. Mbledhin informacion nga të paktën dy burime duke krijuar komente intuitive dhe origjinalitet në përgatitjen e detyrës.
Zgjidhja duke respektuar saktësinë	Zgjidhja përmban shumë gabime.	Zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.	Zgjidhja përmban pak gabime .	Zgjidhja nuk përmban gabime.

shkencore të TIK-ut				
Organizimi i materialit	Materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë.	Materiali është organizuar mirë por jo gjithmonë krijon lehtësi të kuptuari.	Materiali është i organizuar mirë dhe në shumicën e rasteve krijon lehtësi të kuptuari.	Materiali është i organizuar shumë mirë dhe krijon lehtësi të kuptuari.

X. BIBLIOGRAFIA:

- IZHA, 2014, Korniza kurrikulare.
- IZHA, 2014, Kurrikula bërthamë AMU, klasat 10-12.
- IZHA, 2014-2018, Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 10-12.
- IZHA, 2015, Korniza e vlerësimit të nxënësit.
- IZHA, 2016, Nivelet e arritjes (arsimi bazë).
- IZHA, 2017, Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të lartë..
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”
- Armstrong, Thomas. *7 Kinds of Smart: Identifying and Developing Your Multiple Intelligences*. New York: Plume, 1999.
- Armstrong, Thomas. *In Their Own Way: Discovering and Encouraging Your Child’s Multiple Intelligences*, New York: Tarcher/Putnam, 2000.
- Armstrong, Thomas. *Multiple Intelligences in the Classroom* 4th ed. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development, 2018.
- Armstrong, Thomas. *You’re Smarter Than You Think: A Kid’s Guide to Multiple Intelligences*. Minneapolis, MN: Free Spirit, 2014.
- Checkley, K. (1997). The first seven...and the eighth: A conversation with Howard Gardner. *Educational Leadership*, 55 (1). [Online]. Available: www.ascd.org/pubs/el/sept97/gardnerc.html
- Christison, M. (1998). An introduction to multiple intelligence theory and second language learning. In J. Reid (Ed.), *Understanding learning styles in the second language classroom*. (pp. 1-14). New Jersey: Prentice Hall.
- Gardner, H. (1983). *Frames of mind: The theory of multiple intelligences*. New York: Basic Books.
- Gardner, H. (1993). *Multiple intelligences: The theory in practice*. New York: Basic Books.
- Gardner, H. (1999). *Intelligence reframed: Multiple intelligences for the 21st century*. New York: Basic Books.

